

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6768  
E hënë, 29 nëntor 2022  
çmimi 0.40

Mbijetesa e Kosovës si shtet është e mundur nëse kombinohen faktorët adekuatë | FAQE 6-7

Milazim KRASNIQI



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ME AKTIVITETE TË NDRYSHME ËSHTË SHËNUAR 110-VJETORI I PAVARËSISË SË SHQIPËRISË | FAQE 4-5

## NË VLORË BËHET THIRRJE PËR RRUGËTIM TË PËRBASHKËT NË PROCESET QË I PRESIN SHQIPTARËT



Qytetarë të shumtë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi kishin zgjedhur Vlorën për ta festuar 110-vjetorin e pavarësisë e të tjerët me aktivitete të shumta festonin këtë datë në qytete të

ndryshme të këtyre vendeve. Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 110-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, liderët e dy shteteve, Shqipërisë dhe Kosovës, u bënë bashkë të hënën në ceremoninë e ngritjes së

flamurit kombëtar në sheshin "Pavarësia" në Vlorë, ku u tha se kombi shqiptar ka forcuar gjithnjë e më shumë pozitën dhe rolin e tij të merituar si faktor i paqes, stabilitetit dhe fqinjësisë së mirë në rajon

### AKTUALE



**VARHELYI, OPTIMIST SE BOSNJA MUND TA MARRË NË DHJETOR STATUSIN E VENDIT KANDIDAT** F. 2

**PËRURORHET SHTATORJA E ANTON ÇETTËS** F. 3

**AS SAPUNË E AS ÇARÇAFË NË DISA KLINIKA TË QKUK-së** F. 3



### EKONOMI



**110 VJET SHTET, TREGTIA NË MES TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS VAZHDON TË RRIET** F. 8

### SPORT



**PORTUGALIA DHE BRAZILI SIGUROJNË KUALIFIKIMIN** F. 10



## KQZ-ja CERTIFIKON 12 KANDIDATË PËR ZGJEDHJET NË VERI | FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Varhelyi, optimist se Bosnja në dhjetor mund ta marrë statusin e vendit kandidat

SARAJEVË, 28 NËNTOR - Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi, tha se është optimist se Bosnjë-Hercegovina do ta marrë statusin e shtetit kandidat nga blloku evropian në muajin e ardhshëm nëse plotësohen disa kushte që Brukseli i ka paraqitur së fundmi.

Duke folur gjatë një takimi në Sarajevë, më 28 nëntor, me anëtarët e presidencës trepalësh të Bosnjës, Varhelyi i bëri me dije kushtet. Në to përfshihet luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, reformat gjyqësore dhe të migrimit, por edhe garancitë për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen e gazetarëve. "Rruga evropiane është e hapur, por priten rezultate nga Bosnja. U takon liderëve politikë që këto të

bëhen realitet", tha Varhelyi pas takimit me anëtarët e presidencës Denis Beqiroviq, Zhejko Komshiq dhe Zhejka Cvijanoviq.

Në tetor Komisioni Evropian rekomandoi statusin kandidat për Bosnjën, por listoi një sërë kushtesh që duhen plotësuar e të cilat kanë për synim ta forcojnë demokracinë e këtij shteti të Ballkanit Perëndimor.

Por, Komisioni vetëm këshillon se cilat shtete duhen ta marrin statusin e kandidatit. Vendimin përfundimtar e marrin 27 shtetet anëtare dhe ato duhet të marrin vendim unanim.

Disa shtete - sikurse Austria, Kroacia dhe Sllovenia - kanë kërkuar që Bosnjës t'i mundësohet procedurë e shpejtë, pasi Moldavia dhe Ukraina në qershor morën statusin e vendit kandidat. Të tjerët, përfshirë Holandën,

janë shprehur kundër zgjerimit, edhe pse pushtimi i paprovokuar rus i Ukrainës ka thyer rezistencën për shkak të shqetësimeve të sigurisë për Evropën si tërësi. Varhelyi tha se Komisioni Evropian "dëshiron të shohë rezultate të qarta të cilat mund t'i raportojë para Këshillit të BE-së gjatë takimit në dhjetor", ku pritet të vendoset nëse do t'i jepet statusi i kandidatit Bosnjës, pasi "ne jemi në një moment të ri gjeopolitik të luftës në Ukrainë". "Është në interesin tonë që të forcojmë partneritetet tona", tha ai.

Bosnja përbëhet nga Federata e Bosnjë-Hercegovinës, ku boshnjakët që janë shumicë dhe entiteti kroat që është minoritet. Federata ka buxhetin katër herë më të lartë sesa Qeveria kombëtare. Në Bosnjë po ashtu është edhe Republika



Sërpska, ku jeton shumica serbe, dhe qarku vetëqeverisës i Bërçkos. Federata po ashtu është e ndarë në dhjetë kantone. Cvijanoviq, që është anëtarja serbe e presidencës së Bosnjës, tha se është e përkushtuar që të punojë "në çështjet që mund t'i realizojmë", ndërkaq Beqiroviq - anëtari boshnjak i presidencës tha se takimi me

Varhelyin ishte "inkurajues dhe substancial". "Marrja e statusit kandidat do të ishte një inkurajim për të gjithë popullin e Bosnjë e Hercegovinës", tha ai. Ndarja në Federatën boshnjake dhe kroate dhe në entitetin e Republikës Sërpska u bë në bazë të Marrëveshjes së Dejtonit të vitit 1995, që i dha fund luftës tre-vjeçare në këtë shtet.

# ShBA-ja: Rusia shtyn bisedimet për inspektimin e armëve bërthamore

WASHINGTON, 28 NËNTOR - Rusia ka shtyrë bisedimet me Shtetet e Bashkuara lidhur me armët bërthamore, që ishin paraparë të mbaheshin gjatë kësaj jave në Kairo, njoftoi Departamenti amerikan i Shtetit më 28 nëntor, teksa asnjëra palë nuk dha arsye për shtyrjen e bisedimeve. Zyrtarët nga të dyja shtetet ishin paraparë të takoheshin në kryeqytetin egjiptian nga 29 nëntori deri më 6 dhjetor për të diskutuar për rinisjen e inspektimeve nën traktatin New START, që ka për qëllim reduktimin e



armëve bërthamore. Bisedimet ishin pezulluar në mars të vitit 2020 për shkak të pandemisë Covid-

19. "Pala ruse ka informuar SHBA-në se Rusia në mënyrë të njëanshme ka

shtyrë takimin dhe ka thënë se do të propozojë data të reja për mbajtjen e takimit", u tha në deklaratën e një zëdhënësi të DASH-it. DASH nuk ka dhënë informacione të tjera, por tha se Uashingtoni "është i gatshëm të caktojë datën e re sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi që rinisja e inspektimeve është prioritet për ruajtjen e traktatit si instrument të stabilitetit". Ministria e Jashtme e Rusisë ka konfirmuar se bisedimet janë shtyrë. Traktati New START, që hyri në fuqi më 2011, kufizon

numrin e kokave strategjike bërthamore që ShBA-ja dhe Rusia mund të dislokojnë, dhe po ashtu kufizon dislokimin e raketave tokësore dhe atyre të vendosura në nëndetëse. Zëvendësministri i Jashtëm rus, Sergei Ryabkov, kishte ulur shpresat se në bisedimet me SHBA-në do të mund të arrihej ndonjë përparim. Megjithatë, bisedimet mes dy shteteve ishin parë si shenjë se të dyja palët duan të mbajnë dialogun edhe pse raportet mes tyre janë në nivelin më të ulët që nga Lufta e Ftohtë.

# Talibanët në Pakistan i japin fund armëpushimit

Islamabad, 28 nëntor - Talibanët në Pakistan njoftuan se i kanë dhënë fund marrëveshjes së armëpushimit që arritën me qeverinë në qershor, dhe urdhëruan luftëtarët e tyre të kryejnë sulme në mbarë vendin.

Tehreek-e-Taliban Pakistan (TTP), një entitet i ndarë nga talibanët në Afganistan, por që ndan ideologji të ngjashme islamike, ka qenë

përgjegjës për dhjetëra sulme të dhunshme dhe qindra vdekje në mbarë Pakistanin që nga viti 2007. "Teksa operacionet ushtarake po vazhdojnë kundër muxhahedinëve në disa zona të ndryshme... është e rëndësishme që ne të kryejmë sulme ku të mundemi në mbarë vendin", u tha në deklaratën e TTP-së. Për një kohë, TTP-ja a pasur ndikim në zonat fisnore të

Pakistanit, duke imponuar një version radikal të ligjit islamik. Luftëtarët e këtij grupi që nga viti 2010 vijnë në Pakistan kryesisht nga Afganistani fqinj, dhe tani janë inkurajuar edhe më shumë me kthimin në pushtet në Kabul të talibanëve afganë. TTP dhe qeveria pakistaneze arritën një marrëveshje armëpushimi në qershor, por të dyja palët vazhdimisht



kanë pretenduar se pala marrëveshjen dhe kanë tjetër ka shkelur pasur disa përleshje.

## As sapunë e as çarçafë në disa klinika të QKUK-së

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Dyshekë me shenja gjaku - disa të mbuluar me çarçafë e disa edhe pa ta. Këtë pamje pa ekipi i "Radio Evropa e Lirë" në disa dhoma pacientësh të Klinikës së Kirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). "REL" qëndroi atje dy ditë në gjysmën e dytë të nëntorit. "Dhe, nëse shkon në banjë me karrocë, nuk mund të hysh brenda, sepse dyert janë të ngushta. Aty nuk ka as letër, as sapunë... Ne vetë duhet t'i blejmë", tha një pacient i shtrirë në repartin e ortopedisë të kësaj klinike.

Disa pjesëtarë të stafit, që nuk deshën të identifikohen, pranuan se ka mungesa të gjësendeve - sipas tyre - të domosdoshme, dhe thanë se ato ua vështirësojnë punën.

"Nuk kemi as sapunë, as çarçafë. Kirurgjia duhet të ketë çarçafë... [Pacientët] kanë rrjedhje të drenazhit, të qeses urinare... Nuk ka mundësi të ruhet një çarçaf, kur pacienti e ka gjithë atë drenazh", tha një infermiere. Në të njëjtat ditë, "REL" vizitoi edhe Klinikën e Pulmologjisë në QKUK, ku në disa dhoma pa situatë të ngjashme. "Kur kemi ardhur këtu krevati ka qenë pa jastëk e pa mbulesë", tha Lule Dragusha, e cila po kujdeset për nënën e saj të shtrirë në këtë klinikë. "Na kanë thënë se duhet t'i sjellim nga shtëpia. Nuk e kemi ditur se si shkon kjo punë dhe i kemi sjellë", tha ajo.

Kryeinfermierja e Klinikës së Pulmologjisë, Dafina Ramaj, i mohoi këto pretendime. "Nëse dikush nga pacientët dëshiron t'i ketë çarçafët e vet, mund t'i sjellë, por duhet të jenë të bardhë. Përndryshe jemi të furnizuar mjaftueshëm", tha Ramaj për "REL"-in.

Në mes të nëntorit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) - përgjegjëse për inspektime të ndryshme sanitare në Kosovë - urdhëroi mbylljen e disa hapësirave në



QKUK për shkak të, siç tha, mosplotësimit të kushteve higjienike-sanitare.

"Janë mbyllur këto hapësira: Klinika e Fiziatriisë, dy dhoma të Klinikës së Dermatovenerologjisë dhe Reparti i Oftalmologjisë", konfirmoi Inspektorati Sanitar i AUV-it për "REL"-in.

Shërbimet e tyre janë bartur në klinika të tjera derisa kushtet në hapësirat e mbyllura të përmirësohen. Sipas AUV-it, në disa klinika të QKUK-së ka edhe "mungesë të ujit të ngrohtë dhe të mjeteve për higjienë personale" - gjëra të cilat i vërejtë edhe vetë ekipi i REL-it.

Si masa për rritjen e nivelit të higjienës, AUV-i, mes të tjerash, kërkoi që të menaxhohet frekuentimi i vizitorëve në hapësirat e QKUK-së si dhe të sigurohet ujë i ngrohtë aty ku mungon.

Nga Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK) - institucion përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve dhe blerjeve në QKUK - nuk dhanë

përgjigje të saktë në pyetjen se përse situata me higjienën në këtë institucion është e tillë. "Sektori i prokurimit në QKUK ka iniciuar procedura për furnizim me material higjienik, për nevojat e klinikave dhe sektorëve në kuadër të QKUK-së, ku përfshihen: letër për duar, letër tualeti 100 % celulozë e bardhë dhe shampone për duar me shkumë", tha drejtorja e përgjithshme e SHSKUK-së në një përgjigje me shkrim dërguar "Radios Evropa e Lirë".

Ajo nuk dha detaje se kur pritet të kompletohen këto furnizime. Për pastërtinë e klinikave në QKUK është e angazhuar edhe një kompani private, nga e cila konfirmuan se obligim ka vetëm "largimin e mbeturinave nga repartet" dhe "pastrimin e dysHEMEVE dhe të dritareve".

### Mungesa e higjienës, shkak i infeksioneve

Profesionistët shëndetësorë tërheqin vërejtjen se mungesa

e higjienës çon edhe në infektive brendaspitalore. "Rreziku i paraqitjes së infeksioneve është i mundshëm", thotë për "REL"-in kryetari i Shoqatës së Infektologëve të Kosovës, Hamdi Ramadani. "Infeksionet mund të paraqesin probleme të mëdha edhe për stafin shëndetësor", shton ai. Për t'i minimizuar rreziqet e tilla, Ramadani thotë se duhet të shtohen kontrollet sanitare.

Në fund të vitit 2021, "Radio Evropa e Lirë" ka raportuar për rastin e Remzi Rashicës, nga qyteti i Vushtrrisë, i cili ka thënë se për shkak të një infeksioni të marrë në Klinikën e Ortopedisë, ai jeton me këmbë të amputuar. Një raport i mëhershëm i Ekipit për Kontroll të Infeksioneve Brendaspitalore në QKUK gjeti se gjatë vitit 2020 në klinika të ndryshme të këtij institucioni u infektuan 356 pacientë. Sipas raportit, një nga infeksionet më të shpeshta është sepsa, e cila përhapet përmes gjakut dhe mund të shkaktojë dëme

afatgjatë në mushkëri dhe organe të tjera.

Mosrespektimi i masave higjienike u tha se është një nga arsyet kryesore për këtë.

"REL" ka raportuar më herët edhe për mbipopullimin e klinikave të QKUK-së me familjarë që kujdesen për pacientët.

Udhëheqësit e disa klinikave kanë pranuar se në mungesë të stafit të infermierisë kanë nevojë për ndihmën e familjarëve, por jo të një numri të madh të tyre.

Në muajin shtator Qeveria e Kosovës ka njoftuar se ka formuar Komisionin Ekzekutiv për Shëndetësi, përgjegjësitë e të cilit është thënë se do ta përfshijnë zhvillimin e sektorit publik të shëndetësisë. Nuk ka ende ndonjë informacion zyrtar në lidhje me të arriturat e mundshme të këtij komisioni. Kosova është me ushtruese detyre të ministres së Shëndetësisë nga muaji tetor, kur ministri Rifat Latifi ka dhënë dorëheqje.

## Përurohët shtatorja e Anton Çettës

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Anton Çetta ishte institucion i urtësisë kombëtare, u tha në përrurimin e shtatores pranë hapësirave të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në 110-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë.

"Plaku i urtë", siç njihet nga populli, ka pajtuar shumë familje të hasmuara në shumë vise të Kosovës. Profesor Çetta kishte pajtuar rreth 1 800 gjaqe dhe kishte zgjidhur rreth 30 mijë ngatërime.

Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, tha se Anton Çetta ishte i veçantë dhe kishte bërë punë të palodhshme në shumë sfera. "Kujtimi im i parë për profesor Anton Çettën nuk lidhet as me ndonjë vepër të tij shkrimore, por

me një detaj shumë të vogël e që mua më ngjallte shumë kërkshëri. Profesor Çetta në libra mbiemrin e shkruante me dy 't', diçka që mua më ngjante me mbiemrat e kulturave perëndimore, sepse ishte diçka krejt e padëshmuar tjetërkund. Dhe kjo më çonte mua në parafytyrimin se ky njeri duhet të ishte shumë i veçantë", ka theksuar Rama.

Në përrurimin e kësaj shtatore kanë marrë pjesë familjarë të Anton Çettës, të ish-presidentit Ibrahim Rugova, ish-presidentja Atifete Jahjaga, ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ministrja Rozeta Hajdari, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Mehmet Kraja dhe shumë qytetarë.





ME AKTIVITETE TË NDRYSHME ËSHTË SHËNUAR 110-VJETORI I PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

# Në Vlorë bëhet thirrje për rrugëtim të përbashkët në proceset që i presin shqiptarët

Qytetarë të shumtë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Lugina e Preshevës dhe Malit të Zi kishin zgjedhur Vlorën për ta festuar 110-vjetorin e pavarësisë e të tjerët me aktivitete të shumta festonin këtë datë në qytete të ndryshme të këtyre vendeve. Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, liderët e dy shteteve, Shqipërisë dhe Kosovës, u bënë bashkë të hënën në ceremoninë e ngritjes së flamurit kombëtar në sheshin “Pavarësia” në Vlorë, ku u tha se kombi shqiptar ka forcuar gjithnjë e më shumë pozitën dhe rolin e tij të merituar si faktor i paqes, stabilitetit dhe fqinjësisë së mirë në rajon

me lule pranë Monumentit të Pavarësisë.

Të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtua presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, duke i uruar të gjithë shqiptarët për 110-vjetorin e pavarësisë. “Pavarësia e Shqipërisë ishte dhe mbetet vepër e madhe e kombit shqiptar, e brezave dhe patriotëve të panumërt, që me përgjegjësi historike, në ditët e rrezikut të madh, jetësuan vullnetin shekullor të popullit, me shumë guxim dhe largpamësi. Kurora e pavarësisë së Shqipërisë sonë të dashur është e mbushur me gurë të

çmuar, që nga lavdia e Gjergj Kastriotit, te Lidhja Shqiptare e Prizrenit, hapja e shkollës së parë shqipe në Korçë, Lidhja e Pejës, Kongresi i Manastirit dhe kryengritjet e njëpasnjëshme shqiptare në fillim të shekullit XX”, ka thënë ai, duke shtuar se sot i kujtojmë të gjitha këto ngjarje të mëdha të historisë së kombit tonë, që brezat të mos harrojnë, që të kujtojnë me mirënjohje paraardhësit e tyre dhe të mbushen me krenari për atdheun, flamurin dhe identitetin kombëtar. “110 vjet pas shpalljes së pavarësisë jemi dëshmitarë të ndryshimeve të

mëdha që kanë ndodhur në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Ballkan, në Evropë e në mbarë botën. Kombi shqiptar ka forcuar gjithnjë e më shumë pozitën dhe rolin e tij të merituar, duke u bërë një faktor dhe aktor i besueshëm për paqen, stabilitetin dhe fqinjësinë e mirë në rajonin tonë”, ka thënë presidenti Begaj.

Kurse kryeministri Albin Kurti ka thënë se në Vlorë kujtuan historinë. “Çdo vit 28 Nëntori na bën bashkë. 28 Nëntori është pikënisja dhe pikëprerja e kombit tonë. E ne duhet të jemi më shpesh bashkë. Të punojmë bashkë. Të rrugëtojmë bashkë. Sepse duam. Sepse duhet”, ka theksuar kryeministri Albin Kurti.

E presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se akti i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe Dita e Flamurit janë ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. “E nderuar të jem sot në Vlorë krahas liderëve shtetërorë e institucionalë të Kosovës dhe Shqipërisë për ta kremtuar këtë ditë të shenjtë për ne.

Që prej Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, Ismajl Qemalit, Hasan Prishtinës e Isa Boletinit,

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 28 NËNTOR** - Me aktivitete të ndryshme në Tiranë dhe Prishtinë është shënuar 110-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë. Pavarësisht prej temperaturave të ulëta, qytetarë të shumtë kishin dalë për t'i shijuar organizimet me rastin e shënimit të 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Në ditën e shënimit të 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, në Prishtinë u shpalos një flamur përmasash të mëdha me shqiponjë. Ndërkaq një vepër artistike e plisit, një

objekt më shumë se dy metra i lartë, ishte vendosur në sheshin “Skënderbeu” në kuadër të Festivalit të Plisit.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 110-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, presidentja Vjosa Osmani mori pjesë në ceremoninë e ngritjes së flamurit kombëtar në sheshin “Pavarësia” në Vlorë, së bashku me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, kryetarët e kuvendeve të dy vendeve, Glauk Konjufca dhe Lindita Nikolla, kryeministri Edi Rama dhe Albin Kurti.

Në këtë ceremoni ata bënë homazhe dhe vendosën kurorë



e deri te presidenti historik Ibrahim Rugova dhe komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari - një ëndërr dhe një ideal kishim. Sot, Kosovë e Shqipëri, bashkërisht në Vlorë, kujtojmë në këtë 110 vjetor, gra e burra, të cilët e bënë të mundshëm projektin e shteteve tona të pavarura. Siç e kemi bërë bashkërisht rrugën historike, bashkërisht do ta kemi rrugëtimin tonë për në familjen evropiane”, ka thënë Osmani.

### Kabineti qeveritar bën homazhe në Prishtinë, Prekaz, Mitrovicë dhe Prizren

Në 110-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe Ditës së Flamurit, zëvendëskryeministri Besnik Bislimi dhe zëvendëskryeministrja Emilija Redzeqi, së bashku me anëtarë të kabinetit qeveritar dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bënë homazhe fillimisht te shtatorja e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Prishtinë, pastaj te varrezat e familjes Jashari në Prekaz dhe te Kulla e Isa Boletinit në Mitrovicë, ndërkajezë zëvendëskryeministrja Redzeqi bëri homazhe edhe te Lidhja Shqiptare e Prizrenit në Prizren.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi u shpreh krenar për të gjithë ata që për dekada e shekuj kanë punuar palodhshëm dhe me vetëmohim që ne sot të gëzojmë lirinë që e kemi. Ai, po ashtu, tha se duhet të reflektojmë për obligimet që ende nuk i kemi përmbushur,



duke dhënë zotimin që do të punohet çdo ditë të vitit që zotimet e heronjve tanë të realizohen përfundimisht.

#### Edhe Osmani në Prekaz

“I vendosur, guximtar e luftarak. Ky është komandanti legjendar i UÇK-së, Adem

Jashari. Në shënimin e ditës së lindjes, u përlëm para varrit të tij dhe familjarëve, të cilët u bënë fli për lirinë tonë”, kështu ka thënë presidentja Vjosa Osmani pas vizitës që i bëri Kompleksit Memorial “Adem Jashari” dhe familjes Jashari. Ajo ka thënë se Adem Jashari hyri një herë në histori për të

mbetur përherë dhe për t’u kujtuar veçanërisht më 28 nëntor krahas Ditës së Flamurit dhe Pavarësisë së Shqipërisë. “Një ditë dhe tri data historike”, ka theksuar Osmani.

Po ashtu, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Kuvendit të Republikës së

Shqipërisë u mbledhën në Tiranë për nder të 110-vjetorit të pavarësisë Shqipërisë, në mbledhjen e parë të përbashkët midis dy parlamenteve, duke shënuar kështu nivelin më të lartë të bashkëpunimit në historinë e parlamentarizmit të të dyja shteteve.



## KQZ-ja certifikon 12 kandidatë për zgjedhjet në veri

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Dymbëdhjetë kandidatë janë certifikuar për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë në katër komunat në veri të Kosovës, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen më 18 dhjetor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se në mbledhjen e mbajtur më 28 nëntor, përveç certifikimit të kandidatëve dhe subjekteve politike, ka emëruar edhe komisionet e komunave për zgjedhje. Sipas njoftimit, në Lesapoviq janë certifikuar Albulena Behluli-Hetemi nga Partia

Demokratike e Kosovës, Lulzim Hetemi nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Aleksandar Jabllanoviq nga Partia e Serbëve të Kosovës. Në Zubin Potok janë certifikuar për zgjedhje Izmir Zeqiri nga PDK-ja dhe Flatron Hasani nga LV-ja. Në këtë komunë nuk ka kandidatë nga partitë serbe. Në Zveçan, Ilir Peci nga PDK-ja, Fetah Peci nga LV-ja dhe kandidatja e pavarur Sladjana Pantoviq do të garojnë për të parin e komunës. Ndërkaq në Mitrovicë të Veriut do të garojnë katër kandidatë. Në këtë komunë

do të garojë Betim Osmani nga Iniciativa Qytetare Mitrovica, Taulant Kelmendi nga PDK-ja, Erden Atiq nga LV-ja dhe Aleksandar Arsenijoviq nga Iniciativa Qytetare Mbijetesa Serbe. Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë komune në katër komunat në veri po mbahen pas tërheqjes së serbëve nga institucionet e Kosovës në shenjë pakënaqësie me një vendim të Qeverisë në Prishtinë lidhur me reregjistrimin e makinave me targa serbe. Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, më 5 nëntor njoftoi për dorëheqjen



e serbëve nga institucionet e Kosovës, përfshirë ato lokale dhe qendrore. Po ashtu, më 25 dhjetor është caktuar data për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe Leposaviqit. Ndërkaq, me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar, Kosova dhe

Serbia arritën marrëveshje për targat më 23 nëntor dhe, sipas Bashkimit Evropian, Kosova do t’u japë fund veprimeve të mëtejme për reregjistrimin e makinave me targa serbe, ndërkajezë Serbia nuk do të lëshojë më targa të makinave me emra të qyteteve të Kosovës.

# Mbijetesa e Kosovës si shtet është e mundur nëse kombinohen faktorët adekuatë



Milazim KRASNIQI

## I. SFONDI HISTORIK, POLITIK, KULTUROR

1. Kosova u bë shtet në kuadër të procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, e jo si ndonjë korrigjim i padrejtësive historike ndaj shqiptarëve, që janë bërë kundër nesh të kaluarën. Padrejtësi në të kaluarën janë bërë edhe kundër kombeve të tjera në Evropë, fjala vjen, kundër hungarezëve, por ato padrejtësi kanë mbetur të pakorrigjuara. Prandaj, vlerësimi për suksesin e shqiptarëve të Kosovës në bërjen e shtetit, duhet të trajtohet brenda kontekstit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, proces në të cilin Kosova dhe shqiptarët e saj kanë kontribuar realisht, por jo në mënyrë vendimtare, jo aq sa ajo federatë të shpërbëhej nga fuqia gjëmësjellëse e shqiptarëve. Shpërbërjen e ish-Jugosllavisë e ka provokuar në mënyrë vendimtare nacionalsocializmi serb, me projektin e krijimit të Serbisë së Madhe si modifikim i Jugosllavisë së AVNOJ-it, e cila nga doktrina nacionalsocialiste serbe u konsiderua si padrejtësi e bërë ndaj serbëve. Veprimet e lëvizjeve nacionale sllovene, kroate, shqiptare, boshnjake, maqedonase e malazeze për pavarësi, kanë qenë reaktive

ndaj projektit nacionalsocialist serb të Serbisë së Madhe. Në rastin e Kosovës dhe të shqiptarëve, reagimi në vitet tetëdhjetë ka qenë ndaj masave represive, ndaj diskriminimit, ndërsa në vitet nëntëdhjetë ndaj segregacionit e në fund të tyre edhe ndaj spastrimit etnik dhe gjenocidit serb. Pra, lëvizja dhe lufta e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, kanë qenë reaktive dhe ka qenë mbrojtëse. E ka ruajtur brenda vetes edhe elementin e mëhershëm irredentist, por vetëm në një pjesë shumë të vogël të saj. Megjithatë, historia e shtetit të Kosovës, këtij shteti që ekziston sot si i tillë, duhet të fillojë nga narracioni mbi shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, e jo nga ndonjë pretendim megaloman se Kosova u pavarësua falë ndërgjegjes mbi përkatësinë dardane e ilire e madje as të projektit të nacionalizmit shqiptar të periudhës së Rilindjes Kombëtare. Narracionet romantike për të kaluarën heroike të Kosovës, si tokë dardane, si bastion i shqiptarizms, është mirë të mbahen e të kultivohen në sferën e kulturës e të arteve, por jo të mendimit shkencor, politik e shtetëror, sepse në atë rast nuk e shprehin të vërtetën. Në anën tjetër me aso narracionesh të pavërteta dhe

agresive, mund të krijohet perceptimi për shqiptarët si një popull planprishës e rebel, të cilit nuk mund t'i zihet besë as nga Bashkimi Evropian dhe as nga NATO-ja, sepse shqiptarët ditkan të jenë jolojalë dhe të pabesë në situatë krizash, siç qenkëshin treguar jolojalë e të pabesë ndaj ish-federatës, kur ajo ra në krizë. Prandaj, duhet të dominojë narracioni më modest, sipas të cilit përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për dalje nga okupimi serb kanë qenë të imponuara, ndonëse edhe si të tilla, ato ishin të pamjaftueshme për të arritur suksesin, po të mos e fillonte nacionalsocializmi serb procesin e pakthyeshmë të formimit të Serbisë së Madhe, si zëvendësim për ish-federatën jugosllave. Modifikimi i projekteve të shqiptarëve në periudha të ndryshme është dëshmi se atyre u janë imponuar reagimet: nga lëvizja irredentiste (bashkimi me Shqipërinë), në vitet '60-'80 u kalua në një lëvizje integriste (kërkesa për një republikë në kuadër të ish-Jugosllavisë.) Por, pasi eskaloi kriza në vitet nëntëdhjetë, filloi artikulimi i kërkesës për pavarësi, ndonëse edhe deklarata e 2 korrikut 1990 dhe referendumi i shtatorit 991 ende e parashihnin Kosovën si republikë në federatën/konfederatën

jugosllave. Kushtetuta e Kaçanikut e promovoi projektin për Kosovën si shtet i pavarur, por vetëm në letër, ngase Kosova në atë kohë ishte tërësisht e okupuar. Zgjedhjet që u mbajtën (1992 e 1998) proklamoheshin si zgjedhje të një shteti të pavarur, por i cili ishte nën okupim total. Pra, as ato përpjekje e as ato modifikime nuk sollën pavarësimin, sado që e mbajtën të gjallë mobilizimin e popullit në atë kauzë. Raporti i Badenterit, që konstatoi shpërbërjen e ish-federatës jugosllave, ndonëse Kosovën e injoroi, de facto e hapi rrugën që edhe Kosova ta ndiqte rrugën legale të pavarësimit, meqë ishte "element konstituiv i federatës", gjë që më vonë e mori para sysh edhe Gjykata e Drejtësisë, në vlerësimin e pavarësisë së Kosovës në raport me të drejtën ndërkombëtare. Pra, shpërbërja e ish-federatës jugosllave ka krijuar bazën legale të pavarësimit të Kosovës, meqë Kosova me Kushtetutën e vitit 1974 ishte bërë element konstituiv i atij federalizmi.

2. Lufta çlirimtare është dëshmi e avancimit të kërkesave të shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, si reagim ndaj segregacionit, spastrimit etnik dhe gjenocidit serb. Ndonëse me elemente pothuajse mitike të sakrificave, ajo luftë çlirimtare, me kapacitetet e saj, nuk ishte e mjaftueshme për ta arritur çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës nga Serbia. Krahas brutalitetit të Serbisë ndaj saj, edhe oscilimet ideologjike dhe qëndrimet radikale kundër lëvizjes paqësore, i kanë rrezikuar seriozisht mundësitë edhe ashtu të pakta të saj. Marrëveshja e Hollbrukut e tetorit 1998, e cila mundësoi ardhjen e vëzhguesve, ka qenë e rëndësishme strategjike për mbijetesën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si organizatë legale, unike dhe kooperuese me faktorët ndërkombëtarë. Intervenimi i NATO-s, 24 mars-10 qershor 1999 kundër caqeve ushtarake në ish-Jugosllavinë e Zhabllakut, me Marrëveshjen e Kumanovës (9 qershor 1999) mundësoi çlirimin e Kosovës, me çka u hap udha edhe për pavarësimin e saj në 17 shkurt të vitit 2008. Pra, pavarësia e Kosovës ka ardhur edhe si rezultat i intervenimit të NATO-s dhe i një akordi të gjerë ndërkombëtar, të mishëruar në Planin e emisarit të OKB-së, Marti Ahtisarit, e jo si ndonjë aksion i njëanshëm.

3. Armiqësia me Serbinë nuk është mbyllur dhe nuk ka gjasa që të mbyllet as në të ardhmen, në kuadrin ku po kërkohet mbyllja e armiqësisë, në

procesin e tashëm të Brukselit. E vetmja mundësi për të arritur një mbyllje të tyre është nëse Bashkimi Evropian ofron një pako për pranimin e të dyja vendeve në BE, paralelisht me arritjen e marrëveshjes. Por, pakjoja e tillë duhet të përjashtojë çfarëdo mundësie të rishikimit/korrigjimit të kufijve. Ajo mund të akomodojë serbët në veriun e Kosovës, me një zgjidhje me elemente të "rregullimit të rajoneve". Në këtë aspekt, Kosova nuk ka pse ngutet për ndonjë marrëveshje të pafavorshme me Serbinë. Kosova ka pozitë më të mirë se sa Serbia në statuquo: e para, ngase Serbia është shumë më përpara në procesin e integritetit evropian dhe asaj i ngutet të kompletojë procesin, ndërsa Kosova është shumë më larg. E dyta, Kosova tashmë ka në prapavijën e vet tre shtete të reja anëtare të NATO-s, të banuara me shqiptarë, të cilat do të destabilizoheshin nga konflikti eventual Kosovë-Serbi. Prandaj NATO-ja nuk do të lejojë agresionin e Serbisë në drejtim të Kosovës, sepse në atë rast kriza do të përfshinte edhe tre shtete anëtare të saj, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi. Kjo rrethanë i jep Kosovës hapësirë më të gjerë manovruese edhe për marrëveshjen finale, sepse Kosova është në anën e NATO-s, ndërsa Serbia nën influencën direkte të Rusisë.

4. Kosova urgjentisht duhet ta fillojë një proces të gjerë e shumëplanësh evropianizimi, që do të përthekonte legjislativonin, qeverisjen, drejtësinë, mediet dhe shoqërinë mbarë. Përafriimi i ligjeve dhe rekomandimeve me ato të Bashkimit Evropian, reforma zgjedhore, çrrënjosja e korrupsionit, shteti i së drejtës, afirmimi i pakicave, mediet e lira dhe shoqëria e lirë, janë përgjegjësi e shoqërisë dhe e institucioneve të Kosovës. Ata që kujtojnë se duhet të pritet pranimi në BE, që të fillojnë reformat, në fakt janë kundër integritetit dhe kundër anëtarësimit të Kosovës në BE. Qytetarët duhet të ndërgjegjësohen për këtë fakt dhe të mos i votojnë politikanët e dhunshëm, të korruptuar, të padijshëm dhe esencialisht antievropianë. Në instancë të fundit, qytetarët e kanë në dorë evropianizimin e vendit.

5. Realiteti brendashqiptar është mjaft kompleks: një komb, dy shtete dhe pjesëtarë të kombit edhe në disa shtete të tjera në rajon. Këto dy shtete dhe fragmentet në shtetet e tjera, duhet të harmonizohen e të mos lihen të veprojnë spontanisht, sepse në atë rast mund të vijnë në situata që t'i shkaktojnë dëme njëra tjetër, ose edhe të konfliktualitet të ndërsjellë. Nuk duhet të hapen tema lidhur me "pronësinë"

mbi kujtimet e përbashkëta, mbi gjuhën, ose mbi meritat në historinë kombëtare. Kuadri i veprimt dhe diskutimeve të tashme e të ardhshme për të ardhmen e shqiptarëve si komb duhet të vendoset brenda ombrellës atlantike dhe asaj të Bashkimit Evropian, e jo të nacionalromantizmit të shkuar, e aq më pak të ideologjive të falimentuara majtiste.

6. Kombi shqiptar është nga të paktët kombe evropiane, që e kanë aritur sintezën e bashkëjetesës harmonike ndërmjet besimeve të ndryshme fetare brenda të njëjtit komb. Kjo harmoni duhet të kultivohet edhe më shumë në të ardhmen dhe mundësisht të shndërrohet në model edhe për kombet e tjera evropiane, me çka imazhi i shqiptarëve, i dëmtuar rëndë nga çmoralizimi komunist, do të mund të përmirësohej. Respektimi i të drejtave dhe lirive fetare duhet të jetë i plotë, në frymën e Amendamentit të Parë të Kushtetutës Amerikane, që nuk lejon as Kongresin të miratojë ligje që e kufizojnë lirinë e shprehjes.

7. Kultivimi pasionant i gjuhës shqipe në administratë, në medie, në arsimin publik e kudo në komunikim, duhet të jetë orientim strategjik kombëtar. Ky orientim mund të jetë më rezultativ, nëse financohet më shumë kultivimi i letërsisë shqipe dhe nëse financohet përkthimi masiv i literaturës universitare e artistike nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe. Rritja e cilësisë së arsimit, me theks te arsimi universitar, është vendimtar për zhvillimin ekonomik e kulturor dhe për ndryshimin e natyrshëm të elitave.

## II. SFONDI AKTUAL DHE PERSPEKTIV I KOSOVËS

1. Kosova duhet të heqë dorë nga ideologjia irredentiste për bashkimin mekanik me Shqipërinë. Kosova duhet ta forcojë konceptin independetist të shtetit. Bashkimi me Shqipërinë mbetet një ëndërr, por vetëm kur të bëhen Kosova e Shqipëria shtete të suksesshme e të fuqishme dhe kur të hyjnë në kuadër të BE-së dhe NATO-s, ku barrierat për bashkëpunim eliminohen pothuajse tërësisht. Por, duhet të hiqet iluzioni për një bashkim mekanik a me dhunë i dy shteteve shqiptare gati të dështuara. Thjesht, këtij iluzioni duhet t'i vihet pikë. Kosova duhet të profilizohet qartësisht si shtet i pavarur, duke hequr dorë nga kompleksi i inferioritetit edhe në raport me Shqipërinë (si shteti amë!) dhe duhet të krijojë instrumentariumin e miteve që e mbajnë kompakt e të fuqishëm një shtet në kohën tonë. Mitet dhe narracionet e

mëdha e të rreme, të stisura me ngjyra romantike e propagandistike, nuk funksionojnë në kohën postmoderniste. Prandaj duhet të afirmohen narracione më praktike e më të kuptueshme, për gjeneratat e reja të shqiptarëve, të ndikuar edhe nga globalizimi.

2. Respektimi i diversitetit etnik e fetar, është arma më e fuqishme e Kosovës për fuqizimin si shtet, deri sa të jetë nën sponsorizimin e NATO-s dhe nën sponsorizimin e SHBA-ve. Pra, në këtë model duhet të mbështetet e gjithë arkitektura e institucioneve dhe e vlerave tona shoqërore. Edhe kjo mënyrë e konceptimit të shtetit e shoqërisë, krahas heqjes dorë nga ideja irredentiste, mund të zbutë paragjykimet dhe dyshimet e NATO-s, SHBA-ve dhe Evropës, ndaj shumicës myslimane të shqiptarëve. Kjo ka shumë rëndësi, sepse ato paragjykimet dhe dyshimet janë aktive dhe nëse zhvillohen më tutje, mund të prodhojnë keqkuptime serioze. Nëse zbuten ato paragjykimet, kjo mund të frenojë edhe projektin e konvertimit, të cilin Perëndimi e ka aplikuar ndaj popujve të kolonizuar, më së shumti në rastet kur ka dyshuar në lojalitetin e tyre.

3. Praktikimi i një Islami paqësor, adekuat me kontekstin tonë gjeokulturor, gjeopolitik dhe të Postmodernizmit, është mënyra e duhur për një bashkëjetesë paqësore ndërmjet shqiptarëve myslimanë dhe sponsorëve/mbikëqyrësve të pavarësisë së Kosovës. Për këtë objektiv, duhet të bëhet një reformë rrënjësore e bashkësisë fetare, futja e edukimit fetar në shkolla publike dhe përmirësimi i arsimit publik, që të nxirren gjenerata qytetarësh të dijshëm e të aftë për gjykime kritike mbi realitetin ku jetojnë.

4. Kultivimi i një kulture shqiptare më lokale, duke forcuar ndjenjën për gjuhën shqipe dhe duke e mposhtur albabofobinë, të cilën tashmë prezencën ndërkombëtare e ka imponuar në Kosovë, si një gjendje të pashpallur pushtimi.

5. Dekriminalizimi i shoqërisë, me pjesëmarrje shumë më aktive qytetare në zgjedhje dhe në kontrollin demokratik të pushtetit poashtu do të ndihmonte në forcimin e vetërespektit të qytetarëve dhe të identitetit shtetëror të Kosovës, i cili do të duhej të spikaste në plan të parë, pasi ne kemi krizë të theksuar të identitetit shtetëror, e jo aq të identitetit kombëtar.

6. Vlerësimi shkencor i ngjarjeve historike, veçmas lëvizjeve çlirimtare të Kosovës nga Lidhja e Prizrenit e deri në ditët e sotme, me theks tek Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe simbolet e saj, duhet të jetë

pjesë e projektit të forcimit të identitetit shtetëror të Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta e saj, bashkë me partneritetin me NATO-n, duhet të mbetet shtylla kurrizore e historisë së shtetit të Kosovës. Nëse mbetet aktiv dhe fuqizohet miti i saj, ai mit bëhet diga më e fortë kundër projekteve për zbehjen e identitetit shtetëror të Kosovës, po edhe kundër projektit për ndërrimin e identitetit tonë kombëtar e fetar. Në këtë kontekst, evokimi i figurave të heronjve, evokimi i ngjarjeve dhe betejave, evokimi i masakrave të okupatorit serb, çështja e të zhdukurve, çështja e shkatërrimit të objekteve fetare e kulturo-historike, duhet të jetë i vazhdueshëm. Natyrisht, evokimet dhe krenimet do të duhej të bëheshin më me shije estetike, si një projekt shtetëror, e jo spontanisht e me ngjyrimet provinciale. Natyrisht ky projekt shtetëror duhet të begatohet edhe me referimin tek ngjarjet dhe figurat e mëdha të Rilindjes Kombëtare, që shteti i Kosovës të qëndrojë edhe më një trashëgimi të fortë atdhetare.

7. Përpjekja e gjithanshme e elitave dhe e popullit duhet të vazhdojë që të finalizohet e të rehabilitohet Kosova si shtet me shumicë myslimane të popullsisë, por si shtet mirëfilli demokratik, në truallin e Evropës dhe në strukturat e saj. Ky shtet i afishuar si shtet me shumicë muslimane në Evropë, do të ishte test për Perëndimin, se a ka hequr dorë nga taktikat kolonialiste. Në truallin e Evropës ka pasur shtete me shumicë myslimane që nga shekulli VIII (Andaluzia) që me trashëgiminë e vet është inkorporuar në mënyrë unike në rrjedhën e qytetërimit të këtij kontinenti. Pra, Kosova si shtet i ri, me shumicë myslimane, nuk është kurrfarë precedenti, nuk paraqet kurrfarë rreziku, nuk ka asgjë kundërthënëse me qytetërimin perëndimor. Shqiptarët e Kosovës janë me shumicë myslimane, por kanë brenda korpusit të vet nacional edhe pjesëtarë të krishterë, me të cilët jetojnë në harmoni me shekuj. Kjo bashkëjetesë harmonike fetare e shqiptarëve në përgjithësi dhe e shqiptarëve të Kosovës në veçanti, është një model i shkëlqyer edhe për Perëndimin, ku ende nuk është mposhtur islamofobia. Pra, Kosova e këtillë si është, është një shans për Perëndimin, që ta menaxhojë edhe paragjykimin e vet. Në rast se do të hiqte dorë nga taktikat neokolonialiste dhe islamofobike në Kosovë, ajo përvojë do t'i shërbente Perëndimit si model edhe për qëndrim më korrekt ndaj shteteve të shumta myslimane anëkend botës, duke vënë harmoninë ndërmjet besimit islam të popullsisë dhe demokracisë.

## III. PËRBALLJA POLITIKE, JURIDIKE DHE KULTURORE ME SERBINË

Përballja e suksesshme politike, juridike e kulturore me Serbinë është me rëndësi jetike për mbijetesën dhe zhvillimin e Kosovës si shtet i pavarur dhe demokratik. Për të pasur sukses në këtë përballje, duhet të insistohet në këto pika, natyrisht duke i kombinuar dhe duke i aktivizuar në kontekste të ndryshme:

1. Mbajtja lart në agjendë e çështjes së krimeve të Serbisë, spastrimit etnik dhe gjenocidit të viteve 1998-1999 dhe të viteve 1912-1913. Në këtë kontekst, duhet të bëhet kompletimi i dosjes dhe inicimi i padisë kundër Serbisë në Gjykatën e Drejtësisë për krime të luftës. Nga ana tjetër, duhet të bëhet minimizimi i Gjykatës Speciale - prezantimi saj si pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës.

2. Fuqizimi i Luginës së Preshevës, me integrim e bashkëpunim shumëplanësh arsimor, kulturor, ekonomik dhe zgjerimi i kooperimit ekonomik mbi jugun e Serbisë. Bashkëpunimi intensiv dypalësh dhe shumëplanësh me Shqipërinë, si dhe bashkëpunimi me Maqedoninë e Veriut e me Malin e Zi. Në këtë kontekst, duhet të ketë edhe iniciativa konkrete kulturore e arsimore për rikthimin në identitet të shqiptarëve të Peshterit. Stimulimi i rikthimit të shqiptarëve nga mërgatat, integrimi dhe investimet e tyre në Kosovë. Edhe integrimi i plotë i goranëve në shoqërinë dhe shtetin e Kosovës, krahas komuniteteve të tjera duhet të jetë objektiv politik e shtetëror.

3. Fuqizimi i partneritetit euroatlantik të Kosovës, duke rritur disponiminaturus. 4. Duhet të bëhet rishikimi i statusit të Kishës Ortodokse Serbe, duke e futur qartazi në sistemin juridik të vendit tone me një "Marrëveshje Themeltare." Po ashtu, edhe eliminimi i komunave rurale, ose gjetja e formulës për minimizimin e bashkësisë së komunave me shumicë serbe, formimi i së cilës është obligim ndërkombëtar, duhet të jetë një objektiv real.

## IV. FRENIMI STRATEGJIK I SERBISË

Frenimi strategjik i Serbisë si shtet de fakto vasal i Rusisë dhe me varësi të madhe ekonomike edhe nga Kina, mund të zbatohet nga SHBA, NATO e Bashkimi Evropian, nëse insistohet në këto aspekte:

1. Presioni që të mbyllet Qendra Humanitare Ruso-Serbe në Nish. 2. Detyrimi nga ana e BE-së që Serbia të vendos sanksione ndaj Rusisë. 3. Derusifikimi i Gazpromit në Serbi, si element sigurie për BE. 4. Kapitulli 35 të nxirret më herët e jo në fund të negociatave me BE-në. 5. Bllokimi i pasurive dhe pengimi i udhëtimeve të ish-bashkëpunëtorëve të Millosheviqit, përfshirë Daçiqin, Vulinin e Vuçiqin. 6. Pranimi i gjenocidit të kryer në Srebrenicë.

# 110 vjet shtet, tregtia në mes të Shqipërisë dhe Kosovës vazhdon të rritet



**PRISHTINË, 28 NËNTOR** - Në nderim të 110-vjetorit të Pavarësisë, Kuvendi i Kosovës dhe ai Shqipërisë ishin organizatorë të mbledhjes së përbashkët, e para e këtij lloji deri më tani. Që prej janarit të vitit 2014, kur është realizuar takimi i parë i qeverive në Prizren, numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara në këto takime ka tejkaluar 100. Nëse merren parasysh vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova eksporton më së shumti mallra në Shqipëri. Ky eksport është në rritje nga viti në vit, por vlera e tij është ende e ulët në krahasim me importin, mirëpo tregtia në të dyja anët vazhdon të rritet. Kosova është e rëndësishme për eksportet shqiptare, duke u renditur e treta, pas Italisë e Gjermanisë. Vendi ynë është nga

të paktat shtete me të cilat Shqipëria ka bilanc tregtar pozitiv, ku eksportet janë më të larta se importit.

Vendi ynë eksporton në Shqipëri kryesisht mbeturina dhe copëza me përmbajtje hekuri, hekur të përpunuar, pije alkoolike dhe joalkoolike, ndërsa nga Shqipëria importon shufra hekuri dhe çeliku, material ndërtimor, produkte të naftës dhe rrymë elektrike.

Nga të dhënat e tregtisë së jashtme, publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), del se importi, ashtu edhe eksporti me Shqipërinë, në vitin 2021 ishte 266 milionë euro e 858 mijë euro, përkatësisht 111 milionë euro e 329 mijë euro.

Që nga viti 2010 deri më 2021 eksportet e Kosovës në drejtim të

Shqipërisë kanë qenë 693 milionë euro e 126 mijë euro, ndërsa importet ishin 1 miliard euro e 829 milionë euro.

Raporti për vitin 2021 tregon një rritje të eksporteve të Kosovës në drejtim të Shqipërisë prej 1 përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë 2021-s kompanitë e Kosovës në drejtim të tregut shqiptar eksportuan 111 milionë euro nga 110 milionë euro që ishte një vit më herët. Krahasuar me vendet e CEFTA-s, Shqipëria merr pjesë me 14.7 për qind të eksporteve, ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 11.5 për qind, Serbia me 5.9 për qind dhe Mali i Zi me 3.2 për qind, nga totali prej 278 milionë eurosh.

E kundërta po ndodh me importet shqiptare drejt tregut të

Kosovës. Për këtë vit nga Shqipëria janë importuar 267 milionë euro nga 191 milionë euro që ishte gjatë 2020-s. Importet nga vendet e CEFTA-së në këtë muaj arritën në 893 milionë euro. Serbia vazhdon të mbetet vendi me pjesëmarrje më të lartë për import me 6.54 për qind, pasuar nga Shqipëria me 5.7 për qind, Maqedonia e Veriut me 5.2 për qind dhe Bosnjë-Hercegovina me 1.1 për qind.

Hekuri i përpunuar dhe mbeturinat me përmbajtje të tyre janë produktet që Kosova eksporton më së shumti në drejtim të Shqipërisë, që përbëjnë 37 milionë euro nga totali, ndjekur nga pijet alkoolike dhe joalkoolike me një pjesëmarrje prej 15-përqindësh.

Po ashtu, hekuri është produkti

kryesor që kompanitë shqiptare e sjellin në Kosovë. Gjatë 2021-s, janë importuar shufra hekuri dhe çeliku në vlerë prej 123 milionë eurosh. Në drejtim të vendit tonë janë sjellë 31 milionë euro gëlqere, çimento dhe material ndërtimor i fabrikuar. Për këtë vit janë importuar 10.5 milionë euro, me një rritje prej 99-për qindësh krahasuar me 2020-n.

Instituti GAP, Instituti Riinvest dhe Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT) kërkojnë zbatimin e marrëveshjeve të kaluara tregtare. Këto organizata kanë publikuar dy studime mbi marrëveshjet tregtare në mes të dy shteteve, një nga perspektiva e Kosovës me titull "Potenciali tregtar Kosovë - Shqipëri" dhe tjetri nga perspektiva e Shqipërisë "Dy shtete një ekonomi".

Rekomandimet e dala nga këto dy studime përfshijnë pikërisht zbatimin e marrëveshjeve, eliminimin e barrierave dhe shfrytëzimin e potencialeve ekzistuese.

Studimet rekomandojnë, mes të tjerash, ngritjen e një strukture dypalëshe të qëndrueshme, me përfaqësi politike dhe teknike, me mandat të qartë dhe me detyrë monitorimin dhe shpejtimin e zbatimit të marrëveshjeve, heqjen e barrierave dhe ndjekjen e hapave të tjerë drejt integritimit ekonomik; harmonizimin e legjislacionit për taksat dhe akcizat; heqjen e barrierave ekzistuese në kuadër të vendosjes dhe themelimit të biznesit në të dyja vendet; krijimin e instrumenteve të përbashkëta (sikurse Fond i Përbashkët Investimi); si dhe plotësimin e vendimit për përdorimin e Portit të Durrësit nga Dogana e Kosovës për eksport dhe jo vetëm për import. /Telegrafi/

## Çmimet e naftës në botë në nivelin më të ulët që nga dhjetori i 2021-s

**PRISHTINË, 28 NËNTOR** - Çmimet e naftës ranë në nivelin e tyre më të ulët që nga dhjetori 2021 pasi një valë trazirash në Kinë goditi oreksin e investitorëve për asete me rrezik dhe errësoi perspektivën për kërkesën për energji, duke shtuar stresin në një treg tashmë të paqëndrueshëm global të naftës së papërpunuar. Sipas të dhënave të "OilPrice", Brent nafta referencë ndërkombëtare ra 2.53 dollarë ose 3.03 për qind në baza ditore në 81.10 dollarë për fuçi. Nafta e papërpunuar amerikane WTI ra 2.25 dollarë ose 2.95 për qind në 74.03 dollarë për fuçi.

Tërheqja e re e çmimeve të naftës vjen pas disa javësh rëniesh të shkaktuara nga shenjat e një ngadalësimi ekonomik në Kinë dhe vendimi i Bashkimit Evropian për ta kufizuar çmimin e naftës së papërpunuar ruse, i cili duket se ka ndikim minimal në tregti. Spekulatorët kanë reduktuar ndjeshëm investimet në naftë, duke postuar uljen e gjashtë më të madhe në pozicionet e gjata neto në naftën bruto Brent javën e kaluar.

Në ditët në vijim tregu ka të ngjarë të përjetojë më shumë luhatshmëri çmimesh në pritje të takimit të OPEC+ për nivelin e ardhshëm të prodhimit.





# Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe faktori ndërkombëtar



Prof. dr. Ksenofon KRISAFI  
*Akademia Shqiptare e  
Arteve dhe e Shkencave*

Për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, luftën, fitoret, ushtarët, komandantët, heronjtë dhe dëshmorët e saj janë shkruar me qindra mijëra faqe, janë përgatitur mijëra emisione audio-vizive, dokumentarë, filma etj. Mendimi kryesor për vlerësimin e saj fokusohet tek identifikimi me një strukturë ushtarake, e cila u shfaq në formë embrionale në fillimet e viteve '80 të shekullit të kaluar, si reagim ndaj shtypjes së egër nacionale serbe kundër shqiptarëve. Në pranverën e vitit 1998 kishte marrë trajtat e një formacioni të organizuar ushtarako-politik, i një populli të sulmuar, me objektiva, program dhe pikësynim strategjik shkepëputjen e Kosovës nga Serbia dhe krijimin e shtetit të pavarur. Vazhdoi shtimin e pandalshëm të radhëve me luftëtarë, armatosjen e pjesëmarrësve dhe u përlësh me aparatit shtetëror të dhunës serbe, derisa u paraqit si element i rëndësishëm jo vetëm në fushën e betejës, por edhe në raportet me faktorin ndërkombëtar. Me këtë të fundit kuptohen Fuqitë e Mëdha me autoritet në fatet e zhvillimeve botërore, fqinjët, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, rajonale ose universale, politike, ushtarake, ekonomike etj. Më e spikatura midis tyre është OKB-ja me disa prej organeve të saj, Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Sigurimit, Komisioni i të Drejtave të Njeriut – KDNJ (pas vitit 2006 u quajt Këshilli i të Drejtave të Njeriut), por edhe OSBE-ja, NATO-ja, BE-ja etj. Bota politiko-diplomatike, e cila deri në atë kohë kishte vlerësuar, me të drejtë, rolin dhe kontributet e presidentit Ibrahim Rugova në çështjen e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, gjykoi dhe pranoi tashmë se UÇK-ja ishte shfaqur si një forcë e rëndësishme politiko-ushtarake mjaft aktive, si faktor përcaktues dhe si bashkëbiseduese serioze dhe e përgjegjshme.

## Perëndimi dhe UÇK-ja

Kur u përhapën lajmet e para rreth UÇK-së, kancelaritë perëndimore patën rezerva serioze. Madje nuk ngurruan ta cilësonin me etiketime nga më të skajshmet. Por shpejt cilësimi dhe emërtimi i UÇK-së do të evoluonte. E quajtën "forcë ekstremiste", pastaj "forcë guerile", më tej i dhanë emërtimin

neutral "luftëtarë" dhe në fund e pagëzuan si "forcë çlirimtare". Ishte meritë e drejtuesve kryesorë, e organizimit juridiko-institucional, përkushtimit, seriozitetit, përgjegjshmërisë, sjelljeve korrekte humanitare etj. që Perëndimi të arrinte në vlerësimin e sipërpërmendur.

Kthesa drejt njohjes u formalizua në takimin e parë të përfaqësuesve politikë të saj, me një delegacion amerikan, ku merrte pjesë edhe Robert Gelbard (Robert S. Gelbard), i dërguar i posaçëm i presidentit Bill Clinton (William Jefferson Clinton). Takimi u bë në Gjenevë dhe është vlerësuar ndër më vendimtarët për afirmimin ndërkombëtar të UÇK-së.

Uashingtoni, i cili deri në shkurtin e vitit 1998 e quante grup terrorist, duket se ishte lëkundur në opinionet e veta dhe vendosi ta njihte nga afër. I dërguari i presidentit do t'u thoshte përfaqësuesve të UÇK-së se: "Ishte kënaqësi që patëm rastin të bisedojmë me ju kaq gjatë dhe kaq hollësisht. Mund t'ju themi se jemi shumë të kënaqur që, më në fund, takuam dikë nga Kosova që e di se çfarë do, që di si ta kërkojë, di ta mbrojë kërkesën e vet, njëkohësisht e di se si ta realizojë atë".

Vlerësimi i mësipërm tregon se tashmë ShBA-ja kishte ndryshuar qëndrimin ndaj UÇK-së dhe atyre që i prinin. Takimi i Gjenevës u pasua nga një tjetër, kësaj here në Junik, më 24 qershor 1998, ku Riçard Hollbruk (Richard Holbrooke), i shoqëruar nga ambasadori amerikan në Maqedoni, Kristofer Hill (Christopher Hill), bisedoi me përfaqësuesit e UÇK-së, Gani Shehun dhe Hajdin Abazin (Lum Haxhia), në prani edhe të Fehmi Aganit, Veton Surroit, Blerim Shalës si dhe të disa dhjetër-agazetarëve.

Vlerësimet e ndërkombëtarëve për UÇK-në nuk ishin të njëjta, qoftë edhe për faktin se vinin nga drejtme dhe kohë të ndryshme. Disa nga anëtarët e NATO-s shpreheshin kundër takimeve me përfaqësuesit e saj. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të BE-së, më 29 qershor 1998, u tha se u veprua gamim me bisedimet e emisarëve amerikanë Riçard Hollbruk dhe Robert Gelbard me UÇK-në. Jorgo Papandreu, ministri grek i Punëve të Jashtme, deklaroi se duhej "evituar lënia e përshtypjes të UÇK-ja se po mbështetej rivendikimi i saj për pavarësi". Ministrat u shprehën kundër pavarësisë së Kosovës. Pranoni vetëm një status special me autonomi të zgjeruar brenda Republikës Federative të Jugosllavisë. Me gjuhën tipike inerte të vënies në një plan të fajtorit me viktimit, dënuan çdo akt dhune me qëllime politike dhe iu bënë thirrje drejtuesve të

bashkësisë shqiptare të Kosovës që ta "dëshmonin qartësisht angazhimin e tyre në favor të dialogut dhe të një zgjidhjeje politike të problemeve të Kosovës, si dhe hedhjen poshtë të dhunës dhe akteve terroriste".

Nga ana tjetër, antishqiptarizmi, ngutja dhe padurimi i Beogradit për realizimin e synimeve dhe objektivit të tij final, spastrimin etnik të shqiptarëve në Kosovë, ndikuan në përqëndrimin e situatave, por edhe në demaskimin e shpejtë të alibive të vazhdueshme, për gatishmërinë fiktive për të gjetur zgjidhje të pranueshme.

Ishte kjo arsyeja pse sërish mbledhja e ministrave të jashtëm të BE, e mbajtur në Bruksel më 13 korrik 1998, ripërsëriti formulën abstrakte të mbledhjes së mëparshme. Por, ndryshe nga më parë, kërkoi ndalimin e menjëhershëm të armiqësisë dhe rifillimin e bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe shqiptarëve të Kosovës, me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të bashkësisë ndërkombëtare. Ministrat bënë edhe një tjetër hap spektakolar përpara, vendosën që të përdorej forca, nëse ndonjë nga palët në konflikt do ta bllokonte procesin e bisedimeve. Ata u shprehën pro votimit nga Këshilli i Sigurimit të një rezolute që do ta afirmonte mbështetjen e Kombeve të Bashkuara ndaj përpjekjeve ndërkombëtare deri në ndërmarrjen e veprimeve në përputhje me Kartën e OKB-së për t'i bindur ata që bllokojnë procesin për t'iu nënshtruar kërkesave të tij.

Një element tjetër i ri ishte fakti që këtë radhë, për herë të parë, ministrat u shprehën se përgjegjësia për shpërthimin e armiqësisë në Kosovë binte mbi Beogradin dhe se serbët duhet t'i krijonin kushtet për dialog. Në të njëjtën kohë u pranua se bashkësia shqiptare në Kosovë, përfshirë grupet e armatosura, duhet të "ishin gjithashtu pjesë e negociatave", me kusht që të përmbaheshin nga përdorimi i dhunës dhe nga aktet e "terrorizmit". Ministrat e BE-së u shprehën për tërheqjen e forcave të sigurisë, "fajtores" të "represionit civil", lejimin e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe të organizatave humanitare, rikthimin e refugjatëve dhe të zhvendosurve. Kërkuan të ndalohej menjëherë asistencën e jashtme dhe mbështetja ndaj grupeve të armatosura. Njëkohësisht iu bënë thirrje "drejtuesve të bashkësisë shqiptare në Kosovë që të bashkohen dhe të bëjnë kauzë të përbashkët" për bisedimet e ardhshme dhe të caktojnë në këto bisedime një "ekip... plotësisht përfaqësues të bashkësisë së vet". BE-ja njohu shprehimisht nevojën e përfshirjes së UÇK-së (pa e përmendur shprehimisht) në procesin e rikthimit të paqes në

Kosovë.

Sekretarja e shtetit, Medlinë Ollbrajt (Madeleine Jana Korbel Albright), e tronditur nga lajmet që vinin për zhvillimet në raportet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve, të cilat bënë fjalë për ekzekutime masive, masakra të përditshme, foli për mundësinë reale të një katastrofe humanitare në Kosovë. Madje e akuzoi haptas Beogradin për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit. Ajo pati parasysh edhe rezolutën e atyre ditëve të OKB-së, të cilën e cilësoi si shprehjen e një zëri unik të bashkësisë ndërkombëtare, të vullnetit të saj për ta shtrënguar Beogradin që t'i jepte fund ofensivës në Kosovë.

Mizoritë serbe u përmendën zyrtarisht nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së, në raportin e 5 tetorit 1998, pak ditë më vonë, nga NATO-ja në urdhrin e 12 dhe 13 tetorit 1998 dhe sërish nga presidenti Clinton. Më 2 tetor 1998 ai deklaroi se ShBA-ja dhe aleatët e vet duhet të tregoheshin shumë energjikë përballë Sllobodan Millosheviqit (Slobodan Milošević), për ta ndaluar dhunën në Kosovë, për arritjen e një rregullimi përmes negociatash dhe për të mos lejuar që "mijëra njerëz të merren peng nga një luftë, të vdesin nga uria ose nga të ftohtit, sepse ata janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre", siç u shpreh ai.

"Millosheviqi ka dëbuar me qindra mijëra shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e veta, por nuk e ka eliminuar UÇK-në. Madje radhët e saj po shtohen dita-ditës. Ajo ka filluar të ndërmarrë ofensiva kundër forcave serbe, të cilat fshihen skutave për t'iu shpëtuar goditjeve ajrore. Tani Millosheviqi po përballet me sigurinë e vazhdimin të fushatës ajrore, me këmbënguljen e UÇK-së dhe me mundësinë për t'iu përgjigjur përpara popullit të vet për fillimin e një konflikti që jo vetëm nuk mund të fitohej, por po i shkaktonte vendit disfatë ushtarake e rrënim ekonomik". Klintoni shprehte vendosmërinë e ShBA-së dhe aleatëve të vet që "Ballkani nuk ka pse të jetë i destinuar si kryeqendra e errësirës në Evropë, një rajon i xhamive të bombarduara, i burrave e i djemve të pushkatuar nga prapa kokës, i grave të reja të përdhunuar, i rrjedhave të historisë së rishkruar apo të fshirë të grupeve ose të individëve. Siç i kanë drejtuar udhëheqësit njerëzit e tyre gjatë një rruge, ata duhet t'i kthejnë këta njerëz drejt një të nesërmeje më të mirë".

## Politika e vetëpërbajtjes e UÇK-së

Përkrahja e gjerë që i erdhi Kosovës nga faktori ndërkombëtar do ta forconte besimin e UÇK-së për realizimin e

kauzës së popullit nga gjiri i të cilit kishte dalë, si dhe do ta inkurajonte vendosjen dhe forcimin e marrëdhënieve të saj me Perëndimin. Nga pikëpamja juridiko-ndërkombëtare, mund të thuhet se UÇK-ja dhe shqiptarët e Kosovës, interesat e shumicës së të cilëve ajo përfaqësonte, me qëndrimet korrekte dhe të përgjegjshme, fituan statusin e palës kryengritëse ose ndërluftuese dhe u cilësuan partnerë të besueshëm në raport me botën e jashtme.

Një aspekt tjetër mjaft domethënës, i vërejtur në fizionominë e UÇK-së, ishte që zgjerimi dhe shtimi i represionit serb kundër shqiptarëve, ndryshe nga sa mund të mendohej, nuk u shoqërua me veprime të njëjta hakmarrëse nga ana e saj. Politika e vetëpërbajtjes, në themel të së cilës u vendos pranimi dhe respektimi i detyrimeve që buronin nga Rezoluta nr. 1199 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, u vlerësua nga faktori ndërkombëtar.

Ishte koha kur Medlinë Ollbrajt paralajmëronte Millosheviqin që, po t'i refuzonte kërkesat ndërkombëtare, do të përballej me pasojë nga më të rëndat, kur i kërkoi NATO-s që t'i aktivizonte forcat ushtarake për ndërhyrje, nëse ai nuk do t'i zbatonte rezolutat e OKB-së. Të njëjtin deklaram bëri ato ditë edhe presidenti Clinton, i cili njoftoi se kishte hapur dritën jeshile për pjesëmarrjen amerikane në sulmet eventuale ajrore kundër Jugosllavisë. Megjithatë, serbët i shpërfillën paralajmërimet dhe përpjekjet për zgjidhjen e butë të situatave ekstreme që vet i kishin krijuar dhe vazhduan ofensivën kundër Kosovës dhe UÇK-së.

Ndërkohë përfaqësuesit e ShBA-së vazhdonin kontaktet me eksponentët e UÇK-së. Prej tyre kërkonin që ta respektonin pushimin e zjarrit dhe të garantonin sigurinë e "verifikuesve" të dërguar në Kosovë nga OSBE-ja. Ishte kjo edhe fryma e bisedimeve të zhvilluara më 17 nëntor 1998, në Dragobil të Malishevës, ndërmjet Kristofer Hillit me delegacionin e UÇK-së i përbërë nga Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja.

Takimet e emisarëve të lartë amerikanë me përfaqësues të UÇK-së dëshmonin për një ndryshim rrënjësor të qëndrimit të faktorit ndërkombëtar ndaj lëvizjes së armatosur shqiptare në Kosovë që, siç u tha, iu "imponua" ShBA-së dhe aleatëve perëndimorë nga misioni që ajo kishte marrë përsipër dhe korrektësia që demonstronte në veprimtarinë e saj. Administrata amerikane e njohu si bashkim "luftëtarësh të lirisë", që "është ngritur atë sa mund ta dëmtojë shumë ushtrinë jugosllave", siç shkruante "Uashington Post". →

Kur NATO-ja filloi sulmet ndaj Serbisë, UÇK-ja ishte bërë e papërmbajtshme, thoshte Klintoni. Ajo “kryente detyrën e forcave tokësore të NATO-s në terren” dhe, siç deklaronte komandanti i NATO-s, Uesli Klark (Wesley Clark), “i detyronte forcat serbe të dilnin në terren të hapur, ku kishim mundësi t’i sulmonim ato”.

Milloseviqi, i mbyllur në skrofullën e vet në Beograd, vazhdonte të përsëriste se pjesëtarët e UÇK-së janë “vrasës, banditë dhe dhunues”, siç i thoshte Joshka Fischerit (Joseph Martin “Joschka” Fischer). Por tashmë dihej mirë se ajo nuk ishte vrasëse.

### UÇK-ja i imponohet Beogradit

UÇK-ja do t’i imponohej zyrtarisht dhe juridikisht edhe vetë Beogradit. Më 13 janar 1999, midis autoriteteve drejtuese të formacioneve ushtarake të UÇK-së dhe atyre serbe, u krye një shkëmbim robëresh. Veprimi, i zakonshëm në pamje të parë, mund të konsiderohet si një hyje zyrtare e saj nga Serbia, pranë i saj si faktor me statusin juridiko-ndërkombëtar të palës ndërluftuese ose palës kryengritëse.

Ndërkohë që njësitë e UÇK-së përlësheshin me forcat serbe në frontet e luftës, ndërkombëtarët organizuan takimin e Rambujesë, midis delegacionit serb dhe atij shqiptar, pjesë thelbësore e të cilit ishin drejtuesin e UÇK-së. Rambujeja shënoi afirmimin dhe njëkohësisht bashkëpunimin e UÇK-së në nivelin më të lartë dhe më të plotë me faktorin ndërkombëtar, me Fuqitë e Mëdha të asaj kohe, veçanërisht me ShBA-në. Ai ishte takimi i parë zyrtar publik me palën serbe, me ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve.

Procesi i Rambujesë dhe marrëveshja e përgatitur për t’u nënshkruar nga shqiptarët dhe serbët ishte një shans i madh sidomos për Serbinë sepse, sipas saj, ajo legjitimohej për ta vazhduar mbajtjen e Kosovës brenda territorit të vet, nëpërmjet një zgjidhjeje politike, të siguruar nga prania ushtarake në terren. Ishte kjo arsyeja pse në atë kohë përfaqësues të krahëve të ndryshme të Lëvizjes kosovare dhe të UÇK-së druanin se me nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë do të zhvleftësoheshin luftërat dhe përpjekjet për pavarësi dhe Kosova do të mbetej sërish nën Serbi. Ajo do ta humbiste përfundimisht Kosovën vetëm nëse do të shkaktohej luftë, sikurse ndodhi realisht.

Beogradi ishte fiksuar në obsesionin e mbajtjes me çdo kusht të Kosovës, shkak për të cilin nuk mori parasysh as edhe sugjerimet e protektoreve të tij më besnike, Rूसisë. Përpjekjet e saj nuk patën rezultat. Ministri i Jashtëm, Ivanov, bëri një tentativë tjetër, për ta bindur Milloseviqin që ta nënshkruante marrëveshjen. Do të shkonte në Beograd për t’i transmetuar

mesazhin “nënshkruaj ose je i humbur”! Beogradin nuk e pranoi, por kjo s’e pengoi Moskën dhe propagandën e saj që të vazhdonte ta ushqente frymën e solidaritetit me serbët, duke ofruar madje mbështetje njerëzore dhe logjistike.

Konferenca e Rambujesë për Kosovën, shkruan Jakup Krasniqi, një ndër drejtuesit kryesorë të UÇK-së, është një ngjarje e shënuar historike në raport me faktorin ndërkombëtar. Me gjithë kundërshtimet që mund t’i këtë kjo ngjarje, rëndësia e saj nuk mund të zbehet as sot e as mot. Ngjarja ishte kryesisht për Kosovën, por në Rambuje dhe rreth saj ishin të gjithë shqiptarët, pa dallim kufijsh. Ishin drejtuesit e shtetit shqiptar, të politikës e të diplomacisë shqiptare, ishin edhe drejtuesit e kulturës dhe shkencës humanitare shqiptare. Ishte e gjithë diaspora, të gjithë në mbështetje të delegacionit, të marrëveshjes që në asnjë mënyrë mos ta humbnim mbështetjen ndërkombëtare. Në fund të fundit, edhe delegacioni i UÇK-së kishte shkuar për ta fituar përkrahjen dhe mbështetjen ndërkombëtare. Dhe mbështetja e fuqishme ndërkombëtare ndodhi.

Me shumë objektivitet, sinçeritet e çiltërsi ky pjesëmarrës i ngjarjes së madhe pranon se “sigurisht edhe drejtuesit politikë dhe ushtarakë të UÇK-së kanë bërë gabime njerëzore gjatë luftës çlirimtare, siç kanë mundur të bëjnë gabime edhe anëtarët e delegacionit të Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë për Kosovën. Se është më se e vërtetë se këto dy ngjarje më kulmore të historisë sonë të lavdishme, janë dy ndeshje të mëdha të shqiptarëve të Kosovës me pushtuesin shekullor (Serbinë), në rrafshin politik, diplomatik dhe ushtarak dhe rezultati është 5:0 për Kosovën. Dhe kjo është meritë e drejtuesve politikë dhe ushtarakë, e jo e atyre që sabotonin, e luftonin kundër UÇK-së, që rrëmbejnë poste dhe organizonin puçe – të tillët vazhdimisht gabojnë, si dje ashtu edhe sot. Zotërinj, kur, në cilën kohë, Kosova ka pasur rezultat më të mirë në raport me Serbinë?” bën një pyetje retorike z. Krasniqi për këtë moment.

Përkundër refuzimit të Beogradit që të aderonte në zgjidhjen e konfliktit përmes negociatave, delegacioni shqiptar nënshkroi marrëveshjen. Për këtë çast Kristofer Hill shprehet se “ishte një moment i ëmbël dhe i hidhur njëkohësisht, sepse të gjithë e dinim, sidomos unë dhe Wolfgang (Petritsch), se në mungesë të firmës serbe dhe me gjendjen e dhunshme që ekzistonte, do të kishte luftë. Por kishte diçka inkurajuese. Pas muajsh të tërë përpjekjesh, kishim arritur ta bindnim udhëheqjen shqiptare të bashkëpunonte dhe kjo ishte një arritje. Mendova që ky ishte një ogur i mirë për të ardhmen...”

Disa nga protagonistët dhe personazhet e rëndësishme politike të kohës janë shprehur për qëndrimin e Milloseviqit ndaj Konferencës, marrëveshjes dhe demarsheve të pafundme të

amerikanëve dhe prerëndimorëve për ta bindur që ta nënshkruante. Ollbrajt e cilësoi “një gënjeshhtar të cilit nuk i besohej”. Toni Bler u shpreh se Milloseviqi vizionin e tij mesjetar e bëri ferr real në Evropën moderne. Ministri i Jashtëm rus, pas takimit me Milloseviqin, shpërtheu duke thënë se tek ai nuk kishte parë tjetër përveç se një idiot të gatshëm për ta filluar luftën.

Toni Bleri dhe Joshka Fischer japin disa të dhëna që flasin për lojën që luante Milloseviqi me ndërkombëtarët. Sipas tyre, ai nënshkroi 18 marrëveshje për armëpushim dhe nuk respektoi asnjërin prej tyre. Nuk respektoi as edhe 73 rezolutat e miratuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Me keqardhje konstatohet se edhe Beogradi i sotëm i Vuçiqit (Aleksandar Vučić), bashkëpunëtorit dhe ndihmësit të Milloseviqit, ecën mbi trashëgiminë e tij të keqe, nënshkruan marrëveshje me Kosovën dhe nuk i zbaton.

Marrëveshjen për Paqe kosovarë, përkundër disa dozave të skepticitizmit nga ndokush, e personifikuan si aktin solemn të nënshkrimit virtual të aleancës ndërmjet Kosovës nga njëra anë dhe ShBA-së e botës prerëndimore nga ana tjetër.

Akademiku Rexhep Qosja, pjesëmarrës në Rambuje, u shpreh se “dorëzanë më të fortë se ç’ka pala shqiptare sot nuk ka pasur asnjë palë gjatë historisë...”

### Bota në krah të Kosovës

Në krah të Kosovës dhe forcës përfaqësuese më të bujshme të saj, UÇK-së, ishin rreshtuar shtete dhe organizata të ndryshme botërore. Kjo u dëshmuar edhe në angazhimin sistematik të një vargu organizatash ndërkombëtare, midis të cilave vend me rëndësi zinin përpjekjet e ndërmarra në kuadrin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Disa nga organet e saj kryesore si Asambleja e Përgjithshme (AP) dhe Këshilli i Sigurimit (KS) si dhe Komisioni i Drejtave të Njeriut (KDNJ) – aktualisht i quajtur Këshilli i të Drejtave të Njeriut – çështjen e Kosovës e kanë pasur herë pas here në rendin e ditës së punimeve të tyre. Ka një numër rezolutash të AP dhe të KS të OKB-së, dokumente dhe raporte të KDNJ-së si dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare.

Në seancën e 19 të sesionit të 55-të të KDNJ-së e mori fjalën Kofi Anan (Kofi Atta Annan), sekretari i përgjithshëm i OKB-së. Përshkrimin e problemeve të mprehta të rruzullit në fushën e të drejtave të njeriut e filloi me gjendjen në Kosovë. Fushata e urryer e “spastrimit etnik”, e zhvilluar në mënyrë metodike nga autoritetet serbe në Kosovë, - tha ai, - duket se ka një objektiv të vetëm: të përzë ose të vrasë sa më shumë që të jetë e mundur shqiptarë të Kosovës, privim i një populli nga të drejtat më themelore të jetës, të lirisë dhe të sigurisë, provokim i një katastrofe humanitare në të gjithë rajonin”.

Paralelisht KDNJ mbajti edhe një debat special kushtuar Kosovës, ku

e morën fjalën një numër i madh delegacionesh. Shumica shfaqën solidaritet me të dhe e dënuan Beogradin, vlerësuan pozitivisht bombardimet e NATO-s në ish-Jugosllavi dhe kërkuan ndërhyrjen e fuqishme të organizatave ndërkombëtare, posaçërisht të Komisionit të të Drejtave të Njeriut etj. Një prej tyre deklaroi se “në Kosovë... serbët praktikuan spastrimin e etnik dhe kryen mizori të papërfytyrueshme... Pavarësia do të ishte e vetmja zgjidhje për problemin e Kosovës”. Janë të panumërta rastet që provojnë dhe demonstron mbështetjen e palëkundur ndaj Kosovës të pothuajse mbarë botës dhe veçanërisht të ShBA-së. Në një shkrim të asaj kohe, vjen një ngjarje me emocione të fuqishme. Thuhet se Yeltsin, në një telefonatë të zhvilluar me Klintonin, më 19 prill të 1999, tri javë pasi NATO kishte nisur fushatën e bombardimeve ndaj trupave të Milloseviqit, kërkonte që lufta e Kosovës të zgjidhej përmes bisedimeve, që do t’i jepnin Kosovës një autonomi të zgjeruar dhe Jugosllavisë do t’i ruante integritetin territorial të njohur ndërkombëtarisht deri në ato ditë. Gjatë telefonatës ata folën edhe për çështje të tjera, por tërheq vëmendjen insistimi i Klintonit për praninë ndërkombëtare ushtarake në Kosovë sepse, sipas tij, pa të shqiptarët nuk do të kthehen kurrë. Forcat serbe kanë djegur fshatrat, i kanë djegur të gjallë, kanë përdhunuar fëmijë dhe nuk ka asnjë mundësi që ata të kthehen pa mbrojtje ushtarake. Kërkesës së Yeltsinit, për ndërprerjen e bombardimeve, ai u përgjigj se ajo ndodh “menjëherë nëse Milloseviqi tërheq ushtrinë nga Kosova... Në të shkuarën Milloseviqi nuk e ka mbajtur fjalën. Na u premtua në tetor tërheqja e trupave, por në vend të kësaj ai dërgoi 40 mijë ushtarë dhe 300 tanke të tjera dhe nisi ta zbatojë planin e vet. Tani duhet të na tregojë me vepra tërheqjen, jo vetëm me fjalë”, thotë Klinton. Veçanërisht sinjifikativ është një raport i KDNJ-së, që mban datën 7 shtator 1999. Ai përmban shumë prova dhe fakte mbi të vërtetat tronditëse, për krimet e padëguara të ushtrisë serbe në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Ato tregojnë se deri ku shkonte imagjinata kriminale institucionale e një regjimi dhe e mijëra njerëzve në shërbim të tij, të indoktrinuar e të ushqyer me urrejtje dhe ndjenja shovinizmi dhe ekspansionizmi ndaj Kosovës. Ajo dëshmon tërthorazi për përvojën e një versioni të “modernizuar” të platformës nacionaliste të Naçertanias, e cila kishte si bosht themelor strategjik shfarosjen dhe asimilimin e shqiptarëve të Kosovës për t’ua marrë atdheun, tokën, shtëpinë, shpirtin, jetën.

### Tirana së bashku me Kosovën

Gjatë luftës në Kosovë shteti shqiptar nuk ndërhyri zyrtarisht me ushtri etj., por kjo nuk do të thotë se qëndroi mënjane. Ai ishte maksimalisht aktiv përkrah UÇK-së dhe gjithë faktorëve të tjerë

relevantë të rezistencës kosovare, çka u duk sidomos në drejtimet e mëposhtme:

a) Shqipëria u vu e tëra në dispozicion të luftës së bijve dhe bijave të saj të Kosovës. Ata që erdhën nga Evropa dhe ShBA-ja u pritën në portet dhe aeroportet shqiptare, u përcollën drejt kufirit për të shkuar në frontet e luftës. b) Një Shqipëri kaloi edhe një pjesë e armatimit dhe municioneve që iu vunë në dispozicion UÇK-së nga burime të ndryshme furnizimi. c) Disa dhjetëra djem nga Shqipëria lanë shtëpitë, familjet, punën, kapërcyen kufirin dhe u rreshtuan në formacionet luftarake të UÇK-së. Jo pak prej tyre derdhën gjakun. Shqipëria ishte e para që hapi zemrat dhe dyert e vendit për disa qindra mijëra shqiptarë të Kosovës, të cilët pushtuesi serb i dëboi nga vatrë amtare.


d) Politika dhe diplomacia shqiptare u vunë tërësisht në dispozicion dhe në shërbim të çështjes së Kosovës. Gjithçka u bë mbi bazën e detyrimit shpirtëror, vëllazëror, pa doza paternalizmi.

Në kohën e luftës së Kosovës drejtues dhe funksionarë të lartë të Shqipërisë, duke filluar nga kryetarët e shtetit, kryeministrat, ministrat e jashtëm, ambasadorët e diplomatët me shërbim në Nju-Jork, Uashington, Bruksel, Gjenevë, Londër, Paris, Vjenë, Romë, Moskë etj., kanë bërë përpjekje të pareshtura në mbrojtje të jetës, dinjitetit, lirisë së vëllazërve të Kosovës dhe të mëvetësisë së tyre nga Beogradi.

Për të dëshmuar solidaritet vëllazëror gjatë negociatave të Rambujesë, si dhe për të ndihmuar në rast nevojë, u dërgua në Paris një delegacion zyrtar shqiptar i kryesuar nga ish-ministri i Punëve të Jashtme Paskal Milo. Në shumicën e kohës ai drejtohej nga zëvendësministri Pëllumb Xhufi. Ndërkohë politika dhe diplomacia shqiptare e Tiranës përballoi një punë të madhe. Një ndër drejtimet e veprimtarisë ishte sensibilizimi i opinionit publik botëror dhe i faktorit ndërkombëtar nëpërmjet evidentimit dhe denoncimit të krimeve të luftës të kryera nga serbët në Kosovë në vitet 1998-1999.

Përfaqësuesit e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare punuan me përkushtim për përgatitjen e rezolutave të AP dhe të KS, të dokumenteve dhe raporteve të KDNJ-së të OKB-së si dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, sikurse edhe për lobimin dhe sponsorizimin e miratimit të tyre nga forumet përkatëse. Ata kanë ndjekur me shumë vëmendje edhe veprimtaritë që ndërmerreshin nga elementët të veçantë të angazhuar në funksione të rëndësishme në këto organizata. Kanë

bashkëpunuar me përfaqësuesit e vendeve të cilët në vitet ’98-’99 shfaqnin simpati ose qëndrime korrekte ndaj UÇK-së dhe shqiptarëve. Të njëjtën gjë kanë bërë edhe me shtetet e tjerë, që për arsye të ndryshme qëndronin neutralë ose ishin pozicionuar kundër aspiratës së shqiptarëve të Kosovës për liri dhe pavarësi.



## Dufi i shqiptarëve antishqiptarë kundër UÇK-së

Një grup politikanësh, të mbështetur nga taborë të vetëquajtur analistë ose opinionistë, në Kosovë e në Tiranë, kanë shpalosur një lloj dufi të papërligjor kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në të njëjtën mënyrë sikurse Beogradi dhe aleatët e tij, edhe këta, me akuza false, u përpoqën jo vetëm ta relativizonin rëndësinë e UÇK-së, ta sabotonin luftën e saj, por edhe ta damkosnin. E quajtën detachment komunistësh, krijesë marksiste, nacionaliste, radikale etj., që mbështetej nga kryetarët e klaneve fisnore, të diasporës kosovare, terroristë, trafikantë dhe shërbime të ndryshme sekrete. Disa prej tyre jo vetëm nuk reagon kur Beogradi ndërmoni nismën e ngritjes së akuzave të pabazuara ndaj drejtuesve të UÇK-së, por u duk se u ndien mirë. Shfrytëzuan rastin që, nëpërmjet alibish, të ndërtonin paralele absurde ndërmjet krimeve të pushtuesve dhe ndonjë veprimi ekcesiv të ndërmarrë nga individë të caktuar. Midis tyre dallohet njëri, i cili prej më shumë se 30 vjetësh dominon në skenën politike shqiptare. Ndërkohë që Medlinë Ollbrajt këmbëngulte dhe i kërkonte delegacionit të Kosovës në Rambuje, na ndihmoni që t'ju ndihmojmë, duke nënshkruar dokumentin, dikush nga maja e hierarkisë politike të Tiranës, në mënyrë të pashpjegueshme i kërkonte delegacionit kosovar të

mos e nënshkruante marrëveshjen, sepse kështu do ta firmoste mbarimin e Kosovës dhe do të ishte tradhtar i çështjes kombëtare shqiptare. "Ju bëj thirrje të mos firmosni, mbasi duke firmosur nxini faqen tuaj dhe faqen e Shqipërisë e të pavarësisë së Kosovës, shkatëroni kombin". Këto fjalë i shqiptonte ish-presidenti i Shqipërisë, ai që disa vjet më parë, duke shkelur Rezolutën e Këshillit të Sigurimit për vendosjen e embargos ndaj Jugosllavisë, lejoi kontrabandën e naftës nga Greqia drejt Serbisë, për ta furnizuar makinerinë e saj të luftës për ta përdorur edhe kundër kosovarëve. Nuk mund të etiketoheshin tradhtarë të çështjes kombëtare ata që kishin mbushur radhët e UÇK-së dhe i ishin kundërvënë ushtrisë serbe me heroizëm, me jetën e tyre. Nuk mund të ishin të tillë ata që pranonin këshillat dashamirëse që vinin nga aleatët më të mëdhenj të shqiptarëve në ato kohë për ta nënshkruar marrëveshjen. Askush nuk kishte të drejtë, cilido që të ishte t'u kërkonte përfaqësuesve të kosovarëve të mos firmosnin, t'u tregonte njerëzve të mençur e trima të Kosovës se ç'duhet të bënin në atë moment crucial të rrugëtimit të tyre të pandalshëm historik drejt lirisë dhe pavarësisë. Për më tepër, politikisht, juridikisht dhe moralisht nuk kishte të drejtë t'i akuzonte "Fuqitë e Mëdha", siç i cilësonte ShBA-ja dhe vendet e Bashkimit Evropian e të NATO-s, se po sabotonin të ardhmen e popullit të Kosovës. Pavarësisht nga justifikimet që u përdorën prej tij,

vite më vonë, për t'i shpëtuar përgjegjësisë morale, politike, kombëtare dhe juridike për këtë qëndrim skajshmërisht të ndeshkueshëm, ai ishte dhe mbetet veprim që mund të konsiderohet si një tjetër akt i rëndë, fatmirësisht i mbetur në tentativë.

## Ismail Kadare, neveri për "biznesmenët e lirisë"

Përballë përpjekjeve të tilla antishqiptare u ngrit fuqishëm personaliteti i Ismail Kadaresë i cili dëshmoi se shqetësohej sinqerisht për fatin e Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Në ato kohë të trazuara ai mendonte dhe përhapte bindshëm krejt të kundërtën. Shënimet e hedhura në Ditarin e vet, dëshmojnë se përjetonte çaste të vështira. Revoltohej sidomos nga sjelljet dhe qëndrimet e disa prej politikaneve shqiptarë, për të cilët shprehej se "... një pjesë e 'liderëve', si në Shqipëri, si në Kosovë, nuk heqin dorë nga mburrjet. Ngrehalucë të pandreqshëm, krejtësisht të pandjeshëm ndaj dramës së popullit, që i ka nxjerrë, të dashuruar pas vetes dhe pas fjalëve të tyre të papërgjegjshme, vazhdojnë të jenë si të dehur... Njëri mburret se është ai që e ka në dorë ç'do të vendoset në Rambuje, se po të mos dojë ai, e të mos shkojë ai, gjithçka duhet të prishet. E një tjetër që nuk ka shkelur kurrë në Kosovë, jep mësim patriotike, bën thirrje që në emër të kësaj apo asaj, Kosova të bëhet shkumb e hi... Dhe është gjithmonë populli shqiptar

që paguan, që mjerohet, që digjet e kullon gjak. Kurse këta 'biznesmenë të lirisë' kanë nevojë të ngutshme të qytetërohen, sepse janë shumë larg nivelit të përfaqësimit që meriton populli shqiptar..."

Ai ndërhyri disa herë deri në instancat më të larta të politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare. Kërkesa për mosnënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë shkonte kundër çështjes kombëtare shqiptare, kundër UÇK-së, binte ndesh me përpjekjet e ShBA-së e të BE-së. Shqiptarët dëgjuan zërin e zemrës së vet dhe aleatët e mëdhenj, ShBA-në dhe BE-në, shpërfillën kërcënimet e ish-presidentit shqiptar, firmosën marrëveshjen e Rambujesë, i bënë vendit shërbimin më të madh dhe tërhoqën mbi vete bekime për maturinë e treguar. Nënshkrimi i marrëveshjes i hapi rrugën zyrtarizimit juridik të lirisë dhe, më tej, pavarësisë së Kosovës.

## Antishqiptarët e faktorit ndërkombëtar

Paralelisht me përkrahjen që i vinte popullit të Kosovës nga shumë drejtime, zhvillohej edhe një propagandë antishqiptare nga faktorë politikë që, për interesa politike, ekonomike etj., ose për solidaritet sllavo-ortodoks, merrnin në mbrojtje Serbinë. Kjo shpjegon arsyen pse janë vërejtur raste, kur edhe individë të ndodhur në funksione të rëndësishme në organe të organizatave ndërkombëtare, nuk kanë hezitur t'i përligjinin

veprimet mizore dhe politikat e genocidit ose spastrimit etnik serb kundër shqiptarëve të Kosovës. Thelbi i arsytimit të tyre ishte që serbët u përfshinë në luftë sepse u provokuan nga shqiptarët, të cilët ishin "shkaku dhe pasoja". Disa funksionarë ndërkombëtarë, në shkelje të statusit të tyre, që imponon paanshmëri dhe objektivitet, e vunë veten përkrah Serbisë. Shpërfillnin faktet dhe të vërtetat, improvizonin justifikime, deformonin imazhin e UÇK-së dhe në përgjithësi të rezistencës shqiptare në Kosovë.

Një ndër shembujt më tipikë është ai i të ndjerit Jiri Dienstbier, i cili, në emër të strukturave ndërkombëtare më autoritare, fliste kundër UÇK-së dhe shqiptarëve. Me keqardhje konstatohet se në raport me shqiptarët ai dhe disa të tjerë si ai, të ndodhur edhe në konflikt interesi me përgjegjësitë që kanë pasur, nuk e kanë kryer detyrën me korrektësi.

Në janarin e vitit 1998 ai ishte caktuar i dërguar special-raportues i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në ish-Jugosllavi. I ardhur nga radhët e opozitës antikomuniste çeke, nga një vend gjeografikisht afër ish-Jugosllavisë, me një të kaluar e cila dominohej nga kundërshtimi i regjimit komunist në vendin e vet, mendohej me të drejtë se do ta kishte relativisht të lehtë për t'i njohur në thelb realitetet dhe do t'i përcillte me frymë realiste. Por raportimet dhe dokumentet që përgatiste ai dhe ekipi i tij, së paku për rastin e Kosovës, karakterizoheshin nga të pavërteta, nga përshkrimi me

ngjyra zbkuruese i qëndrimeve serbe ndaj shqiptarëve dhe kalimi mbi ta i përgjegjësive të stisura. Kjo mënyrë veprimi nuk ishte aksidentale, por vijë e përgjithshme sjelljeje e raportuesit të posaçëm, që vihej re në shumë nga dokumentet që mbanin firmën e tij. Fjala vjen, në Raportin periodik të titulluar “Mbi situatën e të drejtave të njeriut në Republikën Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal të Zi), Republikën e Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinë”, të përmendur më sipër, autori dhe bashkëpunëtorët e tij, teksa pohojnë në formën pavetore “spastrimin etnik të shqiptarëve që ndodhi në pranverë”, nuk e zënë në gojë emrin e serbëve, autorëve të pakontestuar të masakrës shtetërore që kishte ndodhur në të gjithë Kosovën.

Kur nuk kishin kaluar veçse pak muaj nga mbarimi i luftës, kërkonte pa logjikë që situatat në Kosovë të shfaqeshin të ndryshuara menjëherë, sikur atje të mos kishte ndodhur asgjë dhe shqiptarët, pavarësisht se ç’kishin hequr, duhet të rroknin përfaqë vrasësit e tyre.

Gjuha dhe fryma e mësipërme do ta përshkonte edhe raportin e paraqitur në punimet e KDNJ-së, në seancën e 28 marsit të vitit 2000 dhe në seancat e tjera në vijim. Delegacioni shqiptar reagoi në disa raste me një lloj ashpërsie që, hera-herës, tejkalonte taktin diplomatik klasik. Duke pohuar të vërtetat, vinte në dukje mungesat e theksuara në integritetin profesional dhe etik të raportuesit të posaçëm për sa iu përkiste qëndrimeve ndaj shqiptarëve. Në fjalën e mbajtur më 30 mars 2000, kryetari i delegacionit shqiptar deklaroi: “Nuk mund të mos shfaqim habinë dhe keqardhjen për përmbajtjen e politizuar të deklarimit të Raportuesit të posaçëm... Me sa dimë ne, një deklaratë e tillë nuk është dëgjuar ndonjëherë në këtë auditor nga një raportues i posaçëm, i cili mandatin e ka që të punojë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe jo të bëjë politikë. Kur thotë se situata sot është më e keqe se një vit më parë, ai me siguri harron se para një viti rreth një milion shqiptarë ishin dëbuar nga vatrata e tyre, qindra mijëra të tjerë ndiqeshin nëpër male nga vrasësit profesionistë të Millosheviqit, mbi dhjetë mijë veta u vranë, dhjetëra mijëra u burgosën, nga të cilët disa mijëra janë ende në burgjet serbe dhe nuk dihet asgjë për fatin e tyre, dhjetëra mijëra shtëpi u dogjën e u shkatërruan”.

Më tej, ai tha se raportuesi i posaçëm guxon ta kërcënojë dhe ta fyejë popullin e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare, që e etiketon “e ashtuquajtura bashkësi ndërkombëtare”. Duam t’i kujtojmë atij se ishte kjo bashkësi që mundi Millosheviqin, që siguroi kthimin në trojet e veta të familjeve të përgjysmuara shqiptare e që sot është angazhuar për ta rindërtuar jetën në atë vend. Dhe kjo, ndryshe nga sa mendon z. Reporter i posaçëm apo të tjerë si ai, ishte një arritje madhështore e bashkësisë ndërkombëtare... për të cilën

shqiptarët kanë mirënjohje të thellë”.

Në mbyllje të fjalës u pohua se, ndryshe nga z. Reporter, që e paraqet bashkësinë ndërkombëtare si fikcion dhe e pikturon Millosheviqin si të vetmin realitet në rajon, të cilit duhet t’i trembemi të gjithë, ne mendojmë se ai “është i fortë vetëm për ata që e duan të tillë, sepse në realitet është tirani i mjerë dhe i vetmuar i Ballkanit, një kriminel lufte i akuzuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale”. Shtatë muaj më pas, në briefingun e 28 marsit 2001, ku u diskutua sërish rreth raportit të radhës, të paraqitur po prej tij, përfaqësuesi shqiptar i tha në sy, se “gjuha e përdorur gjatë briefingut të sotëm është jo vetëm larg objektivitetit, por tejkalon edhe mandatin tuaj. Nisur nga sa u tha më sipër, unë shtrij pyetjen: cilat janë arsyet personale dhe lidhjet që përcaktojnë pozicionin tuaj të njëanshëm? Ky deklaram u bë sepse, sipas informacioneve të misionit shqiptar në Gjenevë, rezultonte se arsyet e vërteta, që duket se ndikonin në qëndrimin e tij në mbrojtje të Serbisë, kishin të bënin me lidhjet e veçanta fafësnore e familjare me Beogradin. Kadareja, në shkrimin e botuar në “Le Monde”, më 14 dhjetor 1999, thoshte se gjithë i tij, Emil Hajek, kishte ardhur nga Serbia në vitet ’30të shekullit XIX dhe kishte themeluar Akademinë Muzikore. Kishte jetuar në Çeki derisa vdiq, së bashku me një pjesë të familjes së vet. Vajza e tij e quajtur Anna Dienstbier duhet të ishte e ëma e Jiri Dienstbierit.

Një pjesë e rrethit të vet familjar jetonte e punonte në Serbi, duke pasur madje edhe pozita të rëndësishme në hierarkinë zyrtare e partiake të Beogradit. Tezja e Dienstbierit (motra e nënës) ishte një ndër drejtueset kryesore të partisë së Mira Markoviqit – Millosheviqit, kurse burri i saj mbante pozitën e kryeredaktorit të gazetës serbe “Politika”.

Çështjen e raportimeve plot shtrembërime të realitetit në Kosovë, delegacioni e rimori sërish në debatin e përgjithshëm, të sesionit të 57 të Komisionit të të Drejtave të Njeriut, në seancën plenare të pasdites së 29 marsit 2001. Në fjalën e kryetarit të delegacionit shqiptar u deklarua, ndër të tjera, se raportimi i sotëm i Raportuesit të Posaçëm “të ngjallë ndjenja frike dhe tmerrri për situatën në Kosovë dhe rreth saj. Është për të ardhur keq se duket sikur ai përpiket ta nxisë urretjen ndaj shqiptarëve duke i blasfemuar ata me shumë epitete denigruese si ‘terroristë’, ‘banditë’, ‘mafiozë’, ‘luftënxitës’ etj... Për të ndërtuar një shoqëri moderne multietnike (në Kosovë) do të duhej që të punojë edhe pakica serbe, e cila duhet t’i braktisë qëndrimet vetizoluese, t’i eliminojë organet paralele, të përfshihet në administratën e Kosovës dhe të bashkëpunojë me faktorët politikë shqiptarë për ta parë veten si qytetare të saj...”

Në fjalën e mësipërme trajtohej, gjithashtu, edhe situata në Luginën e Preshevës, e cila “ngarkohej kohë pas kohe me ngjarje të rënda, që thellonin diskriminimin dhe ndarjen

ndërmjet shqiptarëve dhe popullsisë serbe... Arsyet e vërtetë të shpërthimit të dhunës në rajon janë politikat antishqiptare të ndjekura historikisht nga regjimet serbe...”

Se kush ishte dhe ç’rol luante Dienstbieri mund të kuptohet lehtë edhe nga fjala e presidentit serb Vojslav Koshtunica, mbajtur në seancën e 30 marsit 2001, në sesionin 57 të KDNJ-së. Që në nisje ai falënderoi Mary Robinsonin – komisare e lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe menjëherë pas saj Dienstbierin. Për këtë, që ishte shfaqur mjaftueshëm edhe si “përkrahës i posaçëm” i Serbisë, tha se “kishte pikturuar një pasqyrë të qartë të situatës të të drejtave të njeriut në Republikën Federale të Jugosllavisë, në Republikën e Kroacisë dhe në Bosnjë-Hercegovinë në raportin e tij (E / KKN.4 / 2001/47 dhe Shtesa.1)”.

Pa as më të voglën brejtje ndërgjegjeje për çka serbët e vet dhe pararendësit e tij, në krye të shtetit jugosllav, iu kishin bërë kroatëve, boshnjakëve dhe, së fundi, shqiptarëve, e vazhdoi fjalën sikur vinte nga ndonjë planet tjetër dhe nuk dinte se ç’kishte ndodhur me shqiptarët dhe të tjerët dhe kush ishte shkaktori. “Populli jugosllav ... – tha ai, – u përball me sfida e ndërtime të një shoqërie të re dhe të lirë, duke luftuar terrorizmin shqiptar, gjë që nuk ishte detyrë e lehtë”.

Këto ia thoshte KDNJ-së, organit të OKB-së, i cili, në raportin e 27 shtatorit 1999, shprehej tekstualisht që “... forcat serbe kryen krime tronditëse gjatë fushatës ajrore të NATO-s... Komisionari i Lartë dëshiron të theksojë se bashkësia ndërkombëtare nuk mund të pranojë që të mbeten të pandëshkuar ata që janë përgjegjës për mizori të tilla të tmerrshme”. Ia thoshte KDNJ, ku pak kohë më parë vetësekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anani, kishte thënë, siç u përmend edhe pak më sipër, se fushata e urryer e “spastrimit etnik”, e zhvilluar në mënyrë metodike nga autoritetet serbe në Kosovë, duket se ka një objektiv të vetëm: të përzë ose të vrasë sa më shumë që të jetë e mundur shqiptarë të Kosovës.

Me qëndrimet e raportuesit të posaçëm bashkoheshin kohë pas kohe edhe përfaqësues të disa shteteve të tjerë. Në një nga fjalimet e veta delegati i Shqipërisë në KDNJ shprehu keqardhjen e vendit të vet dhe shtrij pyetjen “kush nga këta që sot luajnë rolin e avokatit në mbrojtje të Millosheviqit foli në vitin 1989, kur Kosovës iu hoq autonomia, kur iu mbyllën shkollat dhe universiteti shqiptar, radioja dhe televizioni, gazetatat, revistat dhe gjithë botimet e tjera në gjuhën shqipe? Kush e ngriti zërin kur Kosova iu nënshtrua për vite të tëra një regjimi të pashpirt të terrorit shtetëror? Si mund të tolerohet që një regjim gjakatar të mbajë peng një popull prej më shumë se dy milionë banorësh nën pretekstin absurd të domosdoshmërisë së respektimit të ‘sovrانيتit’ të papërligjor? Paragjykimet e këtij

zhvillimi nuk mund dhe nuk duhen lejuar që t’i kundërvihen paqes, ligjit dhe drejtësisë”.

Veprimtaria e Dienstbierit lë përshtypjen sikur ai i kishte vënë për detyrë vetes të pastronte nga ndërgjegjja e Serbisë dhe e serbëve njollat e gjakut dhe gjynahet e rënda ndaj kosovarëve t’ia transferonte UÇK-së.

Përgjeshtrimi i pretendimeve të tij dhe i mbështetësve të Beogradit u bë, ndër të tjera, nga vetë UÇK-ja, e cila u rrit numerikisht, u konsolidua dhe, me ndihmën edhe të faktorit ndërkombëtar, përballoj ofensivat e pushtuesit serb, duke arritur të afirmohej pozitivisht në skenën ndërkombëtare.

## Dik Marti dhe Karla Del Ponte kundër UÇK-së

E njëjta situatë në raport me UÇK-në u riprodhua vite më pas me Dik Martin (Dick Marty). Ai u bë aktor i një skenari antishqiptar, i përgatitur në një terren të ngarkuar me lloj-lloj legendash, historish, thashethemesh etj., të prodhuara në Beograd dhe të qarkulluara nga medime politike, diplomatike e gazetareske.

Me veprimet e tij, me apo pa dashje, iu bashkua Beogradit dhe aleatëve të tij, që përpiqeshin ta zhduknin ose ta denigronin UÇK-në me akuzat false.

Anatemimi ndaj saj zuri fill zyrtarisht më 2011, kur Dik Marti paraqiti, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, një raport të përgatitur, në mos tërësisht, së paku të mbështetur në tekstin dhe “provat” e furnizuara nga shërbime të caktuara të Beogradit. Sipas rekomandimit të tij u krijua Gjykata Speciale për Kosovën. Akuzat ndaj UÇK-së, për trafikim të organeve njerëzore, u përgjeshtruan dhe ranë sepse nuk u gjet ndonjë provë as në Kosovë dhe askund tjetër. Megjithatë, të pavërtetat e raportit Marty, në shkelje të disa prej parimeve të rëndësishme që rregullojnë funksionimin normal të çdo sistemi drejtësie, mbajnë në burg “UÇK-në”. Nuk u provua krimi i pretenduar i trafikimit të organeve njerëzore. Prandaj Shqipëria i kërkoi Këshillit të Evropës për të pasur një raport vijues. Në të njëjtën kohë, kryeministri shqiptar e shtrij çështjen në fjalën që mbajti në sesionin 77 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 24 shtator 2022, duke theksuar se edhe pse dëmi është bërë, Asambleja e Këshillit të Evropës ka nevojë ta njohë të vërtetën dhe ta pranojë kërkesën e Shqipërisë.

Krahas Dik Martit, zvicerania Karla Del Ponte, “rastësisht” me pozicion të lartë ndërkombëtar – kryeprokurore për krimet e luftës në Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavinë, në harmoni të plotë me të, “hetoj krimet” që ua faturuan drejtuesve të UÇK-së dhe i ngarkoi ata me akuzat të pavërtetuara.

UÇK-ja nuk ishte shtet as edhe institucion i ndonjë shteti. Rrjedhimisht nuk ishte firmëtare e

Konventave të Gjenevës të 1949-s. Megjithatë, krejt ndryshe nga Serbia, u udhëhoq nga parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare si dhe nga normat e kodit moral shqiptar të përshkuara nga virtytet e larta njerëzore. Ajo nuk ka cenuar rregullat e zhvillimit të luftës, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me trajtimin e grupeve njerëzore të përfshira në luftë ose të prekura prej saj.

Dik Marti, Karla Del Ponte dhe kori i tyre antishqiptar, bashkohën me një shtet, i cili mundohet të makiazhohë të shkuarën e vet të përgjakur, të improvizojë një histori tjetër, të shpëlarë nga krimet, ekspansioni, shovinizmi. Të vendosura në këtë sfond zhvillimesh këto procese kanë marrë format e një alibie institucionale, që shpërfill norma themelore moralo-juridike dhe etiko-njerëzore. Në emër të dënimit të çdo shkeljeje nga kushdo qoftë, qoftë ajo edhe hipotetike, hedhin baltë mbi rezistencën dhe luftën e Kosovës.

## Qëndrimet e Lajçakut

Reminishencat e këtij qëndrimi gjenden edhe në ditët tona të ndonjë nga segmentet e faktorit ndërkombëtar. Tipa të tillë, sërish, me qëndrimet që mbajnë, duket se zbehin apo më keq zhvendosin përgjegjësitë e rënda të Serbisë për krimet e luftës, gjenocidit, spastrimit etnik etj. Shembujt nisin që në kohën e Luftës së Kosovës, vazhdojnë me shpifjet e Dienstbierit, me të pavërtetat e Dik Martit, me akuzat ndaj zinxhirit komandues të UÇK-së, mbylljen e tyre në dhomat e paraburgimit në Hagë etj. Ato, si për të mos lënë mundësinë e fashitjes së kujtesës historike, përmenden sërish tashmë pas 20 e ca vjetëve të mbarimit të luftës në Kosovë edhe në disa qëndrime të Miroslav Lajçakut, ndërmjetës i BE-së në negociatat ndërmjet Serbisë dhe Kosovës etj. Anësia e tij proserbe lë dyshime se edhe ai është një tjetër sllavo-ortodoks, që ecën në gjurmët e Dienstbierit. Në diskutimet që bëhen për normalizimin e marrëdhënieve të Serbisë me Kosovën me sloganet inflacioniste që deklarohen duket sikur synon ta çlirojë nga fajësia agresoren-Serbinë – për t’ia ngarkuar viktimës-Kosovës.

Miroslav Lajçakut i është ngarkuar një mision shumë fisnik: të kontribuojë për vendosjen dhe për mbajtjen e marrëdhënieve normale ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, të cilët rrethanat e caktuara gjeografike i kanë vendosur pranë njëri-tjetrit, duke i “dënuar”, duan ose jo, që të bashkëjetojnë në emër të jetës, zhvillimit, të ardhmes së brezave njerëzorë. Nga kjo pikëpamje, që të realizohet misioni i Lajçakut, lypset devotshmëri, objektivitet, paanësi e përkushtim dhe mbështetje nga të gjithë faktorët relevantë, përfshirë edhe vetë Lajçakun.

Përpara se të konkludohet dhe të gjykohej për rezultatin e sipërmarrjes që i është besuar, nuk mund të mos mbahet parasysh se ai ka qenë ministër i Jashtëm i Sllovakisë dhe

ambasador i saj në Serbi. Të dyja këto rrethanat, edhe pse mund të shkaktojnë reticenca, mbajtje fryme përpara daljes në konkluzione, nuk duhen paragjykuar në dëm të Kosovës. Mbajtësi i portofolit të ministrit të Jashtëm supozohet që duhet të karakterizohet nga aftësi profesionale, besueshmëri politike për përballimin e angazhimeve me ndjeshmëri dhe vështirësi në realizim, të cilat, ndoshta, nuk mund të vihen në dyshim. Por ato kërkojnë edhe një shkallë të lartë integriteti etiko-moral dhe vlerash humane, të cilat askush nuk ka të drejtë t'i vejë në pikëpyetje. Por, nuk mund të shpërfillet fakti që Lajçak është ish-ministri i Jashtëm i një prej pesë shteteve të BE-së, që ende nuk e ka njohur Kosovën si subjekt të së drejtës ndërkombëtare.

E njëjta situatë jo shumë komode është krijuar edhe me përfaqësuesin e lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borell, ish-ministër i Punëve të Jashtme, Bashkimit Evropian dhe Bashkëpunimit të Qeverisë së Spanjës, e cila, gjithashtu, nuk e njeh Kosovën e pavarur.

Lajçaku është justifikuar se ne punojmë për BE-në dhe jo për vendet tona. Duket disi e vështirë, që një qenie njerëzore të përfaqësojë dhe të mbajë dy qëndrime, një si ish-ministër i Jashtëm i një qeverie që nuk e ka njohur Kosovën, një tjetër si funksionar i BE-së që duhet të punojë për zgjidhjen e problemeve, pikënisja e të cilave ka si premisë bazë pikërisht njohjen e saj. Në këtë kuadër ai ka pohuar se qëndrimi i BE-së është të kërkojë nga të dyja palët që të përmbahen nga veprimet që krijojnë atmosferë të tensionuar. Duke e mirëkuptuar dhe pranuar pohimin e tij, kushdo mund të bëjë pyetjet normale se si ka reaguar ai në rastet e kërcënimeve serioze serbe për lirinë dhe integritetin e Kosovës ose për fushatën e Beogradit për tërheqjen e njohjeve ndërkombëtare ndaj Kosovës nga ana e disa shteteve etj.?

Është detyrë funksionale e tij që ta shohë procesin e negociatave shqiptaro-serbe me realizëm dhe objektivitet, i zhveshur nga simpatitë, preferencat politike ose antipatitë, ta shohë me paanësi, në interes të rregullimeve të drejta, afatgjatë, që të mos cenojnë sërish interesat dhe aspiratat legjitime të shqiptarëve të Kosovës, për t'i plotësuar kërkesat tekanjoze të Beogradit.

Në vlerësimin e tij në postin e ndërmjetësimit nuk ka arsye të paragjykohe për shkak të funksionit të ish-ambasadorit në Beograd, njohjes së vendit dhe gjuhës serbe. Por të vështruara në kontekstin e disa ngjarjeve të deritanishme dhe arsyeve që mund të kenë të bëjnë ose jo me atë vetë, projektohen ndonjëherë hije deziluzionit. Ai ka heshtur, fjala vjen, kur Beograd ka guxuar të pretendojë të marrë kompensime për “humbjen” e Kosovës, ndaj së cilës nuk ka asnjë të drejtë.

Ai ka heshtur edhe për politikën e dubël standardeve të ndjekur prej

tij si për sa i përket zbatimit të marrëveshjeve të përfunduara me Prishtinën, ashtu edhe të drejtave të minoriteteve respektive. Nuk është dëgjuar të shprehet kur iu kërkohet kosovarëve t’iu akordojnë serbëve që jetojnë në Kosovë të drejta që tejkalojnë parametrat e akteve juridiko-ndërkombëtare për minoritetet, nëpërmjet krijimit të të ashtuquajturit Asociacioni i Komunave Serbe (Zajdenica) në Kosovë dhe rezervimit të disa vendeve në parlament. As Borelli dhe as ai, megjithëse njohës të së drejtës ndërkombëtare, e cila reciprocitetin e konsideron si parim themelor, nuk e ngrënë zërin që edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës, e cila aktualisht ndodhet në Serbi, të gëzojnë po ato të drejta që rivendikohen nga serbët në Kosovë, të kenë edhe ata Asociacionin e Komunave me Shumicë Shqiptare në Serbi dhe vendet respektive në parlamentin serb.

Ai dhe grupi i bashkëpunësorëve të tij nuk veprojnë me vendosmëri dhe nevojshtë që të dënohet dhe të ndalohej politika e spastrimit etnik soft, e ndërmarrë nga Beogradi, nëpërmjet të ashtuquajturit pasivizim i adresave të gjendjes civile, çregjistrimit të shqiptarëve nga dokumentacioni zyrtar, nëse nuk jetojnë në vendbanimet e tyre. Është detyrë e tij që të shprehet dhe të veprojë edhe sepse në korrikun e 2022-s Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë që e dënon Serbinë dhe kërkon ndërmarrjen e një hetimi të pavarur për ta sqaruar situatën aktuale për gjenocidin që ajo po kryen në Kosovën Lindore, në Luginën e Preshevës. Funksionarë që paraqiten dhe flasin në emër të parimeve të mëdha të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat qëndrojnë në themelet e BE-së dhe të ardhmes së njerëzimit, nuk mund të heshtin përpara një realiteti ku serbët në Kosovë të diktojnë dhe të llastohen si shtetas të privilegjuar, kurse shqiptarët në Serbi – Kosovën Lindore, të shihen si qenie të dorës së dytë, që mund të dëbohen dhe asimilohen në çdo kohë, me çdo mënyrë dhe me çdo mjet. Nuk mund të ecet më tej në këtë trajektore problematike. Ajo nuk ka sjellë rezultatet e pritura. Përkundrazi, ka inkurajuar arrogancën dhe megalomaninë e atyre, të cilët kodin moral njerëzor i të gjitha kohëve i obligon të paraqiteshin në negociatë duke filluar me shprehjen e pendesës dhe kërkimin e ndjesës për krimet që kanë kryer ndaj shqiptarëve. Një sjellje e tillë, shkajshmerisht tolerante nga ana e faktorit ndërkombëtar, ua ka krijuar idenë serbëve se kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin gjithçka, duke iu lënë të tjerëve asgjë.

Është shprehur njëllor rezervë ndaj caktimit të Lajçakut në këtë detyrë. Për sa kohë që nuk është invokuar ndonjë motiv bindës është avancuar sërish hipoteza e ndjenjës së solidaritetit të pamjaftueshëm pansllavist dhe ortodoks. Kjo rrethanë vendos pikëpyetjen e parë shoqëruar me keqardhje. Buron, ndër të tjera,

edhe nga një qëndrim i shprehur publikisht në vitin 2009, kur thoshte se nuk do të pranonte asnjë iniciativë që do ta kushtëzonte pranimin e Serbisë në BE me njohjen e Kosovës. Tani, kur zyrtarisht i duhet të punojë për një zgjidhje që nuk përkon me deklarimin e 2009-s, ka lënë të kuptohet se kishte ndryshuar qëndrimin pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Në mbrojtje të kërkesës antikonstitucionale të serbëve për themelimin e të ashtuquajturit Asociacion, Lajçaku, ndoshta edhe nga pakujdesia e çastit, ka deklaruar se nuk është problem që të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës. Si ish-ministër dhe si diplomat ai e di mirë që kushtetutat e shteteve sovranë nuk ndryshohen nga funksionarë ndërkombëtarë apo me urdhër të tyre, por nga populli i vet, me votim ose referendum.

Ndërmjetësi i BE-së, i cili në ndonjë rast gjatë bisedimeve shqiptaro-serbe ka ngatërruar karrigen dhe është ulur në një radhë me delegacionin serb, mund ta përmbushte më mirë misionin nëse thellohej në njohjen e historisë dhe të realiteteve në raportet shqiptaro-serbe, sepse shqiptarët, e shpërndarë padrejtësisht në gjashtë shtete, kanë dy nga shtetet e konfiguruar në kushtet më paradoksale në Evropë e, ndoshta, në botë! Janë të vetmit të cilët rrethohen nga të gjitha skajet kufitare nga vëllezërit e tyre shqiptarë, të një gjaku, të një gjuhe, të një etnie, të një konstitucioni shpirtëror e nacional. Një pjesë e tyre u është nënshtruar politikave mizore asimiluese, asgjësuese të spastrimit etnik, të gjenocidit. Ata që kanë mbetur ende në trojet e veta janë shtrënguar me çdo mjet dhune të mos guxojnë as të thonë se janë shqiptarë nga origjina, kombësia, të mos guxojnë as ta flasin gjuhën e tyre amtare, madje t’i ndryshojnë mbiemrat, duke iu shtuar prapashtesat oviq, ovski, is etj. Ato iu vijjnë nga gjuha e shtetit ku i la fati, si formë e rafinuar e dhunës politike shfarosëse. Nuk janë lejuar të bashkohen në një shtet të vetëm, në shtetin e tyre të përbashkët, në shtetin e shqiptarëve, siç ndodh me shumicën e popujve të botës.

Pse? Në emër dhe për llogari të së ashtuquajturës paqe evropiane, në emër të së ashtuquajturit stabilitet dhe ekuilibër rajonal?! Lajçaku, madje edhe Borelli, i cili, gjithashtu, është shprehur me të njëjtën gjuhë, nuk mund t’u japin dot përgjigje pyetjeve se ç’börxh u kanë shqiptarët – evropianët autoktonë, evropianëve të tjerë, një pjesë e tyre të natyralizuar si të tillë diku nga mesi i mijëvjeçarit të parë?! Deri kur do të vazhdojë që jeta, qenia, e ardhmja e shqiptarëve do të mbeten të hipotekuara në kancelaritë e Evropës dhe botës sllavo-ortodokse?

BE-ja është serioze, thotë me të drejtë Lajçaku, dhe se ai vetë është “roje e vlerave evropiane në kërkim të një zgjidhjeje që duhet

t’i afrojë të dyja palët dhe të jetë e pranueshme nga BE-ja, që ajo të jetë në frymën e shekullit 21 dhe jo 19”. Por, ndonjëherë, nuk i shpëton dot gjuhës dhe logjikës së pararendësve, veçanërisht Eduard Grejt, i cili, më 12 gusht 1913, 110 vjet më parë, pasi së bashku me kolegët e vet, ambasadorët e Fuqive të Mëdha, kishin copëtuar mizorisht Shqipërinë, deklaroi se atë (Shqipërinë) e sakrifikuam në emër të paqes evropiane. Edhe Lajçaku, megjithëse pretendon se flet me konceptet e shek. XXI, e një shekulli që duhet të karakterizohet nga nivele të larta emancipimi e qytetërimi, barbarie, respekti reciprok etj., shprehet gati në mënyrë identike sipas mentalitetit të Kongresit të Vjenës, 1814-1815, Kongresit të Berlinit, 1878, ku Shqipëria u trajtua sipas statusit të një shprehjeje gjeografike si edhe të Konferencës së Londrës, 1912-1913, kur ajo u muros në themelet e “paqes” fiktive evropiane.

Pjesë e këtij grupimi që ka marrë si mision t’i sakrifikojë sërish shqiptarët në interes të fqinjëve janë edhe debutantët të tjerë, që pavarësisht se shfaqen në role episodike, mund të sjellin dëme të mëdha. Këta pothuajse me të njëjtin mentalitet, papërgjegjshëmëri dhe antishqiptarizëm, kërkojnë me insistim të imponojnë zgjidhje, fijet e të cilave të çojnë në Beograd.

I tillë është prezantuar vitet e fundit edhe ish-i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell etj. Ky, me sa duket, nën ndikimin e një megalomanie të papërligjur, nuk ka hezituar të artikulojë ndaj shqiptarëve shprehje fyese, që kapërcejnë jo vetëm normat elementare të mirësjelljes dhe protokollit diplomatik, por edhe ato të etikës qytetare. Në një prononcim, në vjeshtën e vitit 2022, kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, e quajti “fashist me përvojë”, sepse ka “mëkatuar” duke ndërmarrë hapa të njëanshëm për vendosjen e reciprocitetit (!) ndaj Serbisë.

Qëndrimin e tij shqiptarët në të dyja anët e kufirit e pritën me dëshpërim, madje nuk e identifikuan si direktivë parimore, zyrtare të Uashingtonit. Roli i rëndësishëm, përcaktues, i Shteteve të Bashkuara në paqësimin e Ballkanit Perëndimor, në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, ka mbetur i pacenuar. Në këtë vështrim shihet me entuziazëm dhe besim angazhimi konstant i Uashingtonit nëpërmjet emisarëve të vet, ku kohët e fundit është dalluar Gabriel Escobar, i dërguari i Posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor.

\*\*\*

Mbi bazën e qëndrimeve të pavendosura, me pririje për ta lehtësuar pozitën e Beogradit, janë ndërmarrë veprime të cilat te

shqiptarët kanë ngjallur deziluzione deri në dëshpërim, sepse iu rikthejnë në kujtesë ndodhi tragjike të së kaluarës, kur faktori ndërkombëtar përgjithësisht ishte kundër tyre.

Lajm trishtues ishte njoftimi i 24 qershorit 2020, i ardhur nga kabineti i prokurorit të specializuar i Kosovës, për ngritjen e akuzave penale ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe një numri drejtuesish të tjerë të UÇK-së, të dyshuar për trafik organesh dhe vepra penale të tjera të kryera gjatë dhe pas luftës së Kosovës. Ata përfunduan në Hagë për t’u hetuar dhe për t’u gjykuar në Dhomat e Specializuara.

Rrjedha e mëtejshme e procesit tregoi se po vihej në diskutim shpresa që drejtësia ndërkombëtare e Hagës do të funksiononte normalisht. Nga njëra anë ishte rasti i identifikimit, gjykimit dhe ndëshkimit me dënime simbolike ose me shpallje pafajësie të politikanëve dhe ushtarakëve serbë, të akuzuar si autorë të krimeve në Kosovë, që vranë rreth 13 deri 15 mijë njerëz të pafajshëm, përdhunuan rreth 20 mijë gra dhe vajza kosovare, “varrosën” në furnaltat e Beogradit trupat e disa qindra vetave të varrë prej tyre. Prandaj shqiptarët përjetojnë një paradoks ekstrem – disa kriminelë neoçetnikë vazhdojnë ta drejtojnë shtetin serb, kurse komandantët kryesorë të UÇK-së janë mbyllur në Hagë.

Këto zhvillime nuk i shërbejnë qetësimin të situatave në Ballkan. UÇK-ja nuk shkoi në Beograd ose në qytete e fshatra të Serbisë të luftonte, të masakronte, të përdhunonte, të shkatërronte sikurse vepruan serbët në Kosovë. Ajo u krijua dhe qëndroi në trojet e veta në mbrojtje të jetës, dinjtetit dhe respektit njerëzor. Në këtë mision ishte dhe mbeti krenaria dhe lavdia e popullit të saj. Është e padrejtë që, nisur nga ngjarje rastësore, të përflitet, të denigrohet dhe të hidhet baltë mbi të, mbi komandantët dhe ushtarët e saj. Lufta e UÇK-së ishte e shenjtë, sublime. Ishte luftë për mbrojtjen e atdheut.

(Marrë nga libri “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare”, botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta “Epoka e re”, përpos në portal, do t’i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjëni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

# Ushtria Çlirimtare e Kosovës, aleate e NATO-s



**Prof. dr. Hysen MATOSHI**  
Drejtor i Institutit  
Albanologjik, Prishtinë

Formati shkencor i këtij aktiviteti vjen pas përpjekjes disiplinës në vitet e fundit për ta deligitimuar të drejtën elementare të secilit komb që të jetë i lirë dhe të vendosë vetë për fatin e vet. Intenca e barazimit të aspiratës shekullore të shqiptarëve për të qenë zot në tokën e tyre me formulimin “ndërmarrje e përbashkët kriminale”, duke e përgjithësuar në këtë mënyrë të veçantë e mundshme të çdo lufte dhe duke mëtuar ta ndryshojë rrënjësisht konceptimin mbi karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës, vjen si një prapavajtje në historinë e njerëzimit. Këtë ridimensionim të pazakontë e ahistorik, të paktën, shkenca e ka për detyrë që ta vlerësojë në mënyrë kritike. Në vështrimin tim do të përpiqem të them diçka mbi karakterin përtej-kombëtar të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që sidomos doli në pah në fazën finale të kësaj lufte, kur bota demokratike e lirisë dhe e robërisë nga Kosova, duke u dalë në krah aspiratave e sakrificave të shumë brezave të shqiptarëve.

Kundruar historikisht aleancat politiko-ushtarake kanë ekzistuar që në periudhat e hershme të zhvillimit të njerëzimit. Nuk është i panjohur as fakti se lidhja e tyre bëhet mbi baza të një interesi të përbashkët ndërmjet palëve që e pranojnë faktin e të qenët aleatë të një-tjetrit dhe kuptohet se sa më të shprehura të jenë interesat e përbashkëta të aleatëve aq më funksionale do të jenë aleancat.

Kosova përbënte njërin ndër ato zona ku autoriteti i forcës së përbashkët ekonomike, politike dhe sidomos ushtarake i ShBA-së dhe i partnerëve të saj, krahas faktorit të brendshëm kosovar, solli përfundimin më të shpejtë të robërisë gati njëshekullore nën okupatorin serb. Edhe pse përmasat e tragjedisë kosovare, e cila përjetohej nga banorët e saj (shqiptarët) për vite me radhë, për Aleancën Veriatlantike

kanë qenë të njohura edhe më herët, intervenimi ushtarak ngjau shumë vjet më vonë, pra vetëm në momentin kur kjo aleancë u bind se do të mund t'i realizonte synimet e saj më lehtë, më me pak sakrifica, a thënë më drejt vetëm atëherë kur në tokën e Kosovës e kishte aleatin e saj politik e ushtarak – Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Reagimi vetëm deklarativ i shumicës së udhëheqjes politike të shqiptarëve ndaj terrorit dhe dhunës gjenocidiale të pushtuesit serb në Kosovë, në mënyrë të barasvlerëshme, të bashkësia ndërkombëtare nxiti vetëm dënimin deklarativ të saj, i cili në rastin më të mirë realizohej përmes ndonjë rezolute joobligative, që miratohej në ndonjërin nga organizmat dytësorë të saj, por që autoriteti i tyre ishte shpërfillur nga serbët aq shumë në krizat e në luftërat e mëhershme të ish-Jugosllavisë. Vetëm dalja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe fillimi i rezistencës së armatosur të shqiptarëve kundër Serbisë i krijoi të gjitha kushtet e domosdoshme për një përgjigje adekuate nga ana e NATO-s e që për rezultat përfundimtar pati dënimin e okupatorit nga Kosova. Dhe ishte tërësisht e pakuptimtë të pritej që Aleanca Veriatlantike ta trajtonte seriozisht çështjen e Kosovës dhe aq më pak që ta konsideronte Kosovën për aleate të saj në kohën kur ajo s'kishte ushtri, përkatësisht një forcë të caktuar ushtarake. Në këtë kuptim Ushtria Çlirimtare e Kosovës përbën një kusht të domosdoshëm. Tashti, më shumë se dy dekada pas përfundimit të luftës, nuk janë të paktë ata zëra, madje edhe mes shqiptarësh, që e kontestojnë luftën çlirimtare të faktorit vendës, duke ia njohur të gjitha meritat për fitore ushtarake Paktit Veriatlantik. Ata ia mohojnë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës rolin të cilin ia pranon edhe bashkësia ndërkombëtare. Kështu, në dokumentin “Marrëveshja për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së”, në pikën 25 të tij, pasusi i parë, thuhet: “...komuniteti ndërkombëtar duhet ta ketë parasysh kontributin e UÇK-së gjatë krizës së Kosovës...”. Sipas këtij vlerësimi, Ushtria Çlirimtare e Kosovës jo vetëm që ishte aleate e bashkësisë ndërkombëtare, konkretisht e NATO-s, në krizën e luftës në Kosovë (pavarësisht sesi do ta quajmë atë), por me faktin se


duhet të merret parasysh kontributi i saj, dëshmohet se ajo që një aleate aq e rëndësishme saqë ndihmesa që dha duket e padiskutueshme edhe për organizmat politikë e ushtarakë ndërkombëtarë. Sot në botë askund nuk shtrohet pyetja se kush fitoi më shumë dhe kush më pak, se kush kishte merita dhe kush jo për fitoren e Koalicionit Antihitlerian gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kishte më shumë merita Britania e Madhe, Franca, Amerika, apo BRSS-ja, kjo është një pyetje që mund të shtrohet vetëm nga pozita të nihilizmit dhe të naivitetit ngaqë, logjikisht, kur fiton aleanca, fitojnë aleatët që kanë marrë pjesë në të dhe s'do mend që frytet e fitores ata do t'i gëzojnë në përputhje me ndihmesën që e dhanë në luftën e përbashkët. Kjo vlen edhe për humbësit. Kanë pësuar disfatë të gjithë ata që, në një mënyrë a në një tjetër, u ngritën kundër NATO-s dhe kundër sulmeve të saj mbi Serbinë. Disfata e tyre, pos ushtarake e politike, është edhe morale e historike. Të rralla janë aleancat të cilat kanë funksionuar me aq përpikëri sikundër e kemi rastin e NATO-s dhe të UÇK-së. Të parët, të përkrahur nga mbarë bota përparimtare, u vërsulën me makinerinë ushtarake nga qielli për ta shkatërruar aparatit e shtetit më gjenocidial në botën e këtij mileniumi, ndërsa të dytët qenë faktori i vetëm që luftoi atë ballë për ballë në tokën e Kosovës. Pra, pavarësisht se a luftohej kundër Serbisë nga ajri, nga deti, apo nga toka, një fakt është i pakontestueshëm: ata të cilët në cilëndo nga këto mënyra e luftonin këtë katurë shtetërore, me premisa kriminale të organizimit të saj, ishin aleatë ndërmjet vete dhe se të gjithë së bashku e fituan luftën. Sukseseve të cilitdo nga këta faktorë u gëzoheshin dhe i

trumbetonin të gjithë aleatët. Në këtë kuptim, zëdhënësi i NATO-s, Xhimi Shia, gjatë fushatës ajrore kundër Jugosllavisë, një të katërtën e kohëzgjatjes së konferencave të shtypit ua kushtonte luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rezultateve pozitive të tyre kundër forcave serbe, sikundër që radiostacioni “Kosova e lirë” dhe agjencia e lajmeve “Kosovapress”, zëdhënëse të luftës çlirimtare të UÇK-së dhe të vetmet burime shqiptare të informimit nga Kosova atëbotë, flisnin me admirim për rezultatet e goditjeve ajrore të NATO-s mbi makinerinë serbe. Pra, është krejtësisht e qartë se NATO-ja nuk shënoi fitore historike vetëm me sulme ajrore dhe pa asnjë ushtar në tokën e Kosovës sikundër provojnë të dëshmojnë kolumnistët dhe aktivistët tanë të “rezistencës paqësore”, përkatësisht të rezistencës së paqenë, duke e mohuar kështu faktin historik se ajo i kishte mijëra ushtarë aleatë në mbarë Kosovën, se i kishte për aleatë ata që donin t'i vinin pikën zgjidhjes së çështjes shqiptare, por kuptohet assesi ata që donin të zgjidheshin në nivele pushtetore papërfundimisht në kurrizin e kësaj çështjeje. Intencat e këtilla zhvlerësuese të rolit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në raport me kontributin e saj për lirinë e Kosovës, për fat të keq, në diskursin tonë publik, që e kultivuan qarqe të caktuara politike e mediale të Kosovës, me kohë, do të evoluonin në akuza ndaj pjesëtarëve të kësaj ushtrie, për të arritur në një situatë të ngritjes së aktakuzave ndaj tyre. Fakti i të qenit aleat a besëlidhës me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nga shumë funksionarë të Paktit Veriatlantik, përkatësisht përfaqësues të shteteve që bëjnë pjesë në të, nuk është mohuar ndonjëse kanë

munguar nënshkrimet e saj ceremoniale e pompoze. Megjithatë, një gjë është e sigurt: aleancat nuk i lidhin vetëm nënshkrimet, ngaqë ato lidhen, në rend të parë, dhe më fort për interesat e përbashkëta, të cilat në këtë rast u puqën në një objekt të vetëm: dënimin e Serbisë nga Kosova, me çka iu hap perspektiva e ndritshme lirisë, pavarësisht e demokracisë në Kosovë, që edhe ishte qëllimi i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa NATO-ja, pos që e ka fituar luftën kundër dominimit sllav në Ballkan, duke e zgjeruar në këtë mënyrë sferën e interesave dhe të ndikimit të saj, në këtë luftë e ka dëshmuar forcën dhe aftësinë e saj për ta luajtur rolin e faktorit të vetëm me rëndësi për zgjidhjen e krizave të ngjashme në përmasa globale.

Përfundimisht, liria nuk është më pak e vlefshme vetëm për faktin se ajo u fitua në luftën e përbashkët me aleatët tanë ngaqë, ta zëmë, francezët, po edhe anglezët, në saje të aleancave të mençura dhe parimore, e rifituan lirinë në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore. Gjithsesi aleanca me NATO-n nuk duhet parë si hendikep, si pasojë e dobësisë sonë, përkundrazi ajo është arritja më e madhe që e ka shënuar kreu politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, përgjithësisht, shqiptarët e Kosovës, duke zgjedhur më parë se “miqtë” dhe “dashurinë” e tyre për ne, aleatët dhe interesat tona të përbashkëta me ta. NATO-ja, përtej dimensionit historik të bërjes së lirisë, edhe sot e gjithë ditën mbetet rruga më e sigurt e një të ardhmeje prosperuese (paqësore dhe zhvillimore) për Kosovën, për shqiptarët, për rajonin dhe për mbarë botën.

(Marrë nga libri “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare”, botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta “Epoka e re”, përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)



# Roli udhëheqës i UÇK-së për krijimin e shtetit të Republikës së Kosovës



Dr. Dorian KOÇI

Represioni serb në Kosovë, në demonstratat e vitit 1981, heqja e autonomisë së Kosovës më 1989, helmimet e fëmijëve më 1992, represioni dhe masakrat më 1998 e, së fundi, dëbimi bibliki i bashkëkombësve tanë më 1999, përgatitën momentin historik me datën 17 shkurt të vitit 2008, që Kosova të shpallej e lirë dhe e pavarur. Ngjarje të tilla historike të takojnë shumë radhë t'i përjetosh e t'i ndiesh, ndaj në optikën e ngjarjeve që kalojnë si ujë që rrjedh, të duken gati-gati të pabesueshme. Krijimi dhe fillimi i luftës së armatosur nga UÇK-ja në Kosovë në vitet '90 është në fakt sa një lindje e lirisë së Kosovës, por edhe një rrugëtim i përjetimit të idesë së lirisë mes vetë kontinentit evropian. Rënia e Murit të Berlinit në Evropë, përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe triumfi i demokracisë liberale në Evropën Lindore dhanë pamjen e gjëneshtërt se erdhi fundi i historisë që Francis Fukuyama profetizoi në studimin e tij të njohur [1] por, në fakt, konfliktet e ngrira filluan të dalin në sipërfaqe. Shkrimja e akujve të totalitarizmit do të sillte edhe shkrimjen e konflikteve ndëretnike ku vakuumin e ideologjisë së përmbysur të socializmit shkencor do ta zinte shumë shpejt ideologjia e nacionalizmit ekstrem. Rrugëtimi i rinisë shqiptare i Kosovës në fund të viteve '80 dhe fillim të viteve '90 është një rrugëtim identitar për të parë sesi shoqëria jugosllave e fundit të viteve '80, e dominuar nga nacionalizmi serb, shkoi buzë greminës në luftërat e Kroacisë, Bosnjës dhe në parandalimin që iu bë tmerrit pa fund të makthit ndëretnik në Kosovë. Pikësëpari Jugosllavia u përball me krizën e marrëdhënieve ndëretnike midis kombësive që synonin të krijonin shtetet e veta kombëtare. Kjo krizë vinte si një pasqyrim i tendencave të forcës centrifugale që ishte ushtruar mbi Jugosllavinë për të qenë e bashkuar, por që nën realitetet e reja gjithçka po rishikohej, përfshirë edhe tërësinë territoriale të shtetit jugosllav. Nacionalizmi politik si forma më e lartë e nacionalizmit e ushtruar nga politikat shtetërore

që ndjekin vendet në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare gjeti shprehjen e tij më të lartë në periudha të ndryshme në marrëdhëniet e ndërsjella serbe, kroate, slovene, boshnjake, maqedonase, malazeze dhe shqiptare në vitet '90. Në fushën politike, zhvillimet e veçanta apo ngjarjet, siç është një luftë apo ndryshimi i një regjimi, do t'u japin hov shpresave dhe mundësive ose do të shkaktojnë frenim dhe pengesa. [2] Ndryshe nga rasti i Çekosllovakisë, ku me aktin e miratuar më 25 nëntor 1992, përfaqësuesit çekë dhe slovakë ranë dakord për shpërbërjen e Çekosllovakisë që nga 31 dhjetori 1992, Jugosllavia përjetoi ndryshime të tjera. Shpërbërja e Çekosllovakisë ishte rasti i parë dhe i vetëm në Evropën Qendrore e Lindore që një konflikt etnik u zgjidh në mënyrë paqësore pasi zhvillimet në Jugosllavi dhe ish-republikat e BS-së treguan se spiralet e nacionalizmit etnik tërhoqën në vorbullën e tyre dhe morën peng zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin e këtyre vendeve. Vakumi i pushtetit që po ndihej në Evropën Lindore, përfshirë këtu dhe Jugosllavinë, po nxirrte në pah mekanizma të rinj pushteti të ngjashëm me autoritarizmin dhe centralizmin komunist. Nacionalizmi etnik mundësoi dhe aleancat e reja fiktive ndërmjet ish-komunistëve dhe ultranacionalistëve antikomunistë. Leninizmi i zhvlehtësui shoqëritë ballkanike nëpërmjet mospërbushjes së nevojave për shoqëritë civile. Në vend të tyre ai mbështeti modelet kolektivistike, ku individit i dedikohet tërësisht shtetit dhe jo parimeve të lirisë së individit e të drejtave njerëzore. Kur u shkatërrua pushteti komunist, institucionet demokratike filluan të ngriheshin ngadalë dhe ndërhyrja e publikut në vendimmarrje ishte e kufizuar. [3] Sfidat dhe problematikat e tranzicionit të vendeve të Evropës Lindore drejt demokracisë liberale dhe ekonomisë së tregut duke u përqendruar në variablat kryesore apo faktorët kyç që e pamundësuan "normalitetin" demokratik janë: (a) regjimi totalitar dhe kohëzgjatja e tij përkundër formave të tjera autoritare; (b) mungesa e një kulture politike dhe institucionale të trashëguar; (c) ekonomia jofunksionale e paaftë për të konkurruar në tregjet globale si pasojë e privatizimeve klienteliste, mungesa e modeleve të zhvillimit dhe strategjive koherente; (ç) mungesa e shtetit

të së drejtës, ku pushteti i tretë, do të ishte arbitri i paanshëm në garancitë procedurale, marrëdhëniet kontraktuale dhe mbikëqyrëse të pushteteve ekzekutive dhe legjislative. [4] Disa vende në ish-Evropën Lindore, ku përfshihen shumica e vendeve të Evropës Lindore, në saje të reformave të ndërmarra në të gjitha aspektet, e patën më të lehtë kapërcimin e këtyre sfidave duke bërë të mundur që të pranohen anëtarë të NATO-s dhe BE-së pas një periudhe 15-vjeçare. Disa të tjera, përfshirë disa vende të ish-Jugosllavisë dhe Shqipërinë, janë ende në procesin e hapjes së negociatave me BE-në. Ndërsa Kosova, për shkak të pengesave ndërkombëtare të vendeve të BE-së (Greqisë, Rumanisë, Qipros, Sllovakisë dhe Spanjës) që nuk e kanë njohur ende si shtet të pavarur, edhe pse i ka plotësuar kushtet teknike, nuk e ka fituar ende liberalizimin e vizave. Pikërisht në zhgënjimet nga era e rrëzimit të Murit të Berlinit zë fill edhe përforsimi i rezistencës së shqiptarëve në Kosovë. Historia e themelimit dhe luftës së UÇK-së për t'i dhënë popullit shqiptar në Kosovë dinjitetin e munguar dhe lirinë politike nuk mund të mos shikohen si një kronikë e paralajmëruar rrokopujës dhe prishjes së Jugosllavisë, agresioneve serbe në Kroaci e Bosnjë, Konferenca e Dejtonit, lindja e UÇK-së Konferenca e Rambujesë, bombardimet ndaj Serbisë, rezolutat e kombeve të Bashkuara, diplomacia ndëraktive, diplomacia fluturuese, dorëzimi i "Kasapit të Ballkanit"-Millosheviqit, hyrja e trupave të KFOR-it në Kosovë, përpjekjet për stabilizimin e vendit, pakoja Ahtisari e, së fundi, shpallja e Pavarësisë së Kosovës. Në gjithë këtë rrugëtim lëvizin personazhet më të rëndësishëm politikë të fundshekullit XX, si presidenti amerikan Bill Clinton, sekretarja e shtetit Madlin Ollbrajt, ambasadorët Hollbruk e Kristofer Hill, kryeministri britanik Tony Bler, presidenti francez Zhak Shirak, ministri i Punëve të Jashtme italiane Lamberto Dini, kancelari gjerman Gerhard Shroder e ministrat e jashtëm gjermanë Klaus Kinkel e Joshka Fisher, ish-kryeministri spanjoll Felipe Gonzales etj. Në vitin e fundit të shekullit të XX duket sikur Fushë-Kosova e Kosova kthehen në skenë tragjesh shekspiriane, ku luhet fati i një populli të vogël. Mes gjithë këtyre personazheve politikë evropiane shfaqet dhe roli i UÇK-së dhe Hashim Thaçit,

Jakup Krasniqit, Kadri Hysenit, Ramush Hajradinajt, Fatmir Limajt etj. që me staturën e studentëve të etur për arsim, kulturë e identitet për shqiptarët, gjejnë metaforën e lirisë të plazmuar në historinë e pothuajse çdo familjeje shqiptare në Kosovë. Që nga shekulli i iluminizmit e deri në ditët tona humanizmi dhe liria kanë ushqyer breza të tërë të njerëzimit duke mbetur piketa të rëndësishme të shtetndërtimit e filozofisë politike të popujve të Evropës. Pikërisht në këto dy piketa u ringjall feniksi i shpresës për themelimin e shtetit të Kosovës nga UÇK-ja dhe udhëheqësit e saj. Akti i rebelimit të tyre ndaj pushtetit nacionalist e shovinist serb nuk duhet parë si një prishje e sistemit të së drejtës ndërkombëtare as si kundërshtim i një sistemi mbi një krahinë autonome të shtetit të Serbisë. [5] Ai qëndron në fakt si një reflektim i thelbit të konceptit të Evropës si vend ku triumfuan rilindja evropiane dhe humanizmi. Humanistët e Rilindjes besonin se edukimi duhet të përgatisë një njeri për të pasur një ekzistencë dhe mësim të denjë jo vetëm për ta shfaqur realitetin, por edhe për t'i nxitur individët drejt njohjes dhe aplikimit të saj. Ata besonin se një njeri mund të formohej nëpërmjet "artit të elokuencës" dhe se njeriu duhej të ishte në qendër të gjithësisë. Këtë formim intelektual të marrë në katedrat e Evropës, djemtë e rinj të UÇK-së e transformuan në një filozofi udhëheqëse të luftës së vet për liri. Lufta çlirimtare, e udhëhequr nga UÇK-ja, në thelbin e saj programor, kishte shpëtimin e qenies etnike shqiptare nga shfarosja, mbrojtjen e ndaljen e krimeve ndaj shqiptarëve dhe jo ushtrimin e tyre ndaj të tjerëve. Përdorimi i armëve ishte mjeti i fundit i imponuar nga rrethanat, pasi UÇK-ja, në çdo kohë, ka qenë e gatshme për të përfaquar zgjidhjet diplomatike e paqësore, çka dëshmojnë faktet e mirënjohura historike: firmosja e Marrëveshjes së Rambujesë nga ana e përfaqësuesve të saj për zgjidhjen paqësore të krizës, e ofruar nga faktori ndërkombëtar; çarmatosja e menjëhershme e pa rezistencë e UÇK-së me hyrjen e forcave të NATO-së e atyre paqeruajtëse si dhe pranimit, ushtrimi e respektimi i zgjedhjeve të lira e demokratike nga tërë forcat politike në Kosovë e çliruar. [6] Pa dyshim që Hashim Thaçi ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim, në të njëjtën kohë ai e

komandantët e tjerë të UÇK-së u shndërruan në gardianët e lirisë së shqiptarëve duke e ruajtur luftën për liri të shqiptarëve të Kosovës nga infiltrimet e lëvizjeve islamike, bashkëngjitjes me idetë e mykura marksiste-leniniste apo dhe akuzave si një produkt i krimin të organizuar. Presidenti Thaçi ka treguar intuitën politike të një burri shteti kur kërkoi garancitë shtesë në Rambuje për ta firmosur marrëveshjen që do t'i hapte rrugë formimit të shtetit të Kosovës, organizimit të Partisë Demokratike të Kosovës në paqe, negociatat për pavarësi me Ahtisarin dhe fillimin e dialogut Serbi-Kosovë. "Studimi i së shkuarës për të kuptuar më së miri të tashmen ishte i nevojshëm, por të bësh historinë iu duk më e dobishme për kauzën e lirisë" [7] thotë Jacques Baudouin, këshilltari i ish-Ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Bernard Kouchner, kur përshkruan në librin e vet "Lindja e një demokracie: Hashim Thaçi dhe rruga drejt Kosovës së pavarur (1987-2008)", maturinë politike e shndërrimin politik nga studenti i historisë Thaçi, në burrin e shtetit që themeloi shtetin e Kosovës. Kjo histori e djemve të UÇK-së është trashëgimia historike mbi të cilën është ndërtuar shteti i Republikës së Kosovës. Sot Republika e Kosovës ka një trashëgimi shumë të mirë historike të përpjekjeve të veta për liri, një trashëgimi shumë të mirë kushtetuese të njohur edhe nga komuniteti ndërkombëtar me vendimin e Gjykatës së Hagës që legjitimoi të drejtën e Kosovës [8] për t'u shpallur vend i pavarur si dhe një trashëgimi kulturore të mbështetur në rrënjët evropiane të kulturës shqiptare. [9] Mbështetjen ndaj luftës çlirimtare të popullit të Kosovës, të së drejtës së tij për liri e pavarësi, e shpreh dhe fakti i njohjes së pavarësisë së Kosovës prej 112 shtetesh, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shumicën e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe anëtarësimi i saj në shumë institucione ndërkombëtare. Legjitimiteti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës është pranuar dhe vlerësuar si i tillë dhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë që është segment i OKB-së. [10] Sigurisht që vështirësitë që hasen në shtrirjen dhe vendosjen e shtetit ligjor në pjesën veriore të Kosovës janë sfida që meritojnë vëmendje të veçantë për të përzgjedhur opsionet më të mira të

mundshme. Por ashtu si në Rambuje, ku udhëheqësit politik të UÇK-së i duhej të rrezikonte duke veshur mantelin e politikanit, dhe braktisur formatin e nacionalistit romantik, edhe në ditët e sotme Kosova dhe populli shqiptar kanë nevojë për vizionin e një politikani me përvojë më se 24-vjeçare po aq sa është dhe jetëgjatësia e fillimit të shtetndërtimit të Kosovës. Sot ajo që po përjetohet në Kosovë i përngjet një ëndrrë dikur të konsideruar si të paarrtshme, por ja që brezat e rinj të lindur në Kosovë po e përjetojnë çdo ditë. Mirëpo, ashtu si dihet zakonisht, se ëndrra dhe realizimi i saj zgjat shumë shkurt dhe pastaj vjen realiteti, edhe shqiptarët shumë shpejt, pasi kanë shijuar ëndrrën e tyre për themelimin e shtetit të Kosovës, u është dashur të përballohen me realitetin, i cili shpeshherë nuk ka qenë lajle lule, por edhe i zymtë dhe i trishtë. Pas një periudhe 14-vjeçare shteti i Kosovës, edhe pse ka kaluar përmes shumë vështirësive për t'i themeluar dhe përsosur institucionet e tij, i nevojitet ende ndihma bujare e komunitetit ndërkombëtar për t'i kuptuar realitetet përmes vendimit për liberalizimin e vizave dhe dhënies jetë të ëndrrës evropiane të Kosovës. Republika e Kosovës në këto vite ka arritur ta përforcojë identitetin e vet shtetformues dhe të promovojë maturi në politikat e jashtme në rajon. Në këtë 14-vjetor të lindjes së

demokracisë liberale me të re në Evropë, sigurisht që një ndjenjë falënderimie madhe i drejtohet komunitetit ndërkombëtar në krye me ShBA-në që bëri të mundur çlirimin e saj nga okupatorët serbë, ndaj në horizont nuk mund të ketë asnjëherë asnjë irritim apo acarim në mes të Kosovës dhe aleatit të vet strategjik, sepse shqiptarët në fundin e shekullit të kaluar u bënë dëshmitarë jo vetëm të shprehjes që "liria fitohet", por se ajo edhe mund të "dhurohet". Njëqind e dyzetë një vjet më parë Fuqitë e Mëdha filluan ta riformatojnë hartën e Ballkanit nëpërmjet bombardimit të qytetit të Ulqinit për të zbatuar një nga vendimet e mbrapshta të Kongresit të Berlinit, që ishte dorëzimi i qytetit me popullsi shqiptare Mbretërisë së Malit të Zi. Ishin po këto pasardhëse të këtyre Fuqive të Mëdha, që njëqind e nëntëmbëdhjetë vjet më vonë bombarduan Beogradin për t'u sjellë lirinë e mohuar atyre që aq lehtë u kishin sakrifikuar fatin historik në Konferencën e Londrës.[11] Suksesi më i madh i postnacionalizmit shqiptar është pavarësia e Kosovës, statusi i shqiptareve në Maqedoni e në Mal të Zi. Të përpiqesh që t'i vendosësh zhvillimet e këtij postnacionalizmi nën një qendër sipas modelit Cavurian është e pamundur dhe jorealiste. Shekulli XXI nuk është shekulli XIX, shekulli i nacionalizmave dhe shoqëritë shqiptare në rajon kanë pasur paradigma të ndryshme

zhvillimi nga njëra-tjetra. Qasja moderne që duhet të mbizotërojë në zgjidhjen gjithëpërfshirëse të çështjes shqiptare në Ballkan është përbashkimi i të gjitha rrymave të mendimit shqiptar në një patriotizëm kushtetues shqiptar drejt një qeverisjeje më të mirë dhe mirëqenie ekonomike me standarde të larta. Kjo ecuri e proceseve demokratike është ndërprerë nga një atentat ligjor ndaj ëndrrës shekullore të popullit shqiptar të Kosovës. Për fat të keq, sot disa nga ish-udhëheqësit e UÇK-së që ndërtuan dhe shtetin modern të Kosovës u është hequr liria dhe po hetohen në dhomat speciale të Gjykatës së Hagës. Pa dashur t'i paragjykojmë hetimet nëse ato do të ndërmerren sërish nuk mund të rrimë këtu pa nënvizuar se ngjarja ngjan, në fakt, si një film horror. Një film, një skenar që i përmban të gjitha klišetë e mundshme të historive të shekullit XIX, ku shqiptarët paraqiteshin si "barbarë" dhe të "pacivilizuar" që vrisnin, prisnin dhe rrëmbenin mbi popullsitë e tjera "paqedashëse" të Ballkanit. Aktakuza kryesore ndaj udhëheqësve të UÇK-së është mbështetur mbi raportin e politikanit zviceran Dick Martyit të vitit 2010 të titulluar 'Inhuman Treatment of People and Illicit Trafficking in Human Organs in Kosovo'. Dhomat e Specializuara janë një precedent historik; ato janë imponuar me vendim politik të Këshillit të Evropës, bazuar mbi një aktakuzë publike, gjithashtu

politike. Si të tilla, gjithkush ka të drejtën t'i shprehë vlerësimet e mospajtimet për gjithçka që lidhet me reflektimin e këtyre akuzave dhe qëllimeve politike gjatë ngritjes së Dhomave të Specializuara dhe në veprimtarinë e mëtejshme të saj, pasi kjo vë në dyshim e komprometon paanësinë e besimin për një gjykim të drejtë e të pandikuar.[12] Raporti famëkeq i Dick Martit, i konsideruar tashmë raport i pabazuar në fakte dhe paragjykes ndaj shqiptarëve, zgjon nga gjumi Drakulën e famshëm dhe ua vesh shqiptarëve, të cilët, në ditën me diell dhe nga aeroporti i vetëm zyrtar i shtetit të tyre, bëjnë trafik organesh! Por s'mbetet me kaq, për trafikun dinë shërbimet e fshehta shqiptare dhe organizatori kryesor i tyre është kryeministri i një vendi sovran. Deklaratat e tij lënë pa gojë opinionin botëror dhe aty ku asnjë nuk mund të flasë pasi janë shumë të shokuar nga amatorizmi i paraqitjes së hamendësimeve si fakte, bash vjen një zë nga Moska i ministrit të Jashtëm rus, Lavrov, që e "dinte prej kohësh se UÇK-ja ishte e përfshirë në këto veprimtari kriminale". Nga ana tjetër e oqeanit, një zonjë që ka shkuar për pushime diplomatike në Argjentinë, pasi ka dështuar plotësisht kapjen dhe dënimin e kriminelëve të luftës në ish-Jugosllavi, përsërit sërish fantazitë e saj të përshkruara në librin që s'mundi dot të bëhej bestseller edhe pse zonja lloboi shumë që

t'ia arrinte këtij qëllimi.[13] Gjatë gjithë kësaj periudhe, asnjë gjykatë, përfshirë dhe Gjykatën e Hagës për ish-Jugosllavinë, që ishte gjykata më e specializuar e më e lartë ndërkombëtare për krime lufte, ashtu dhe as ato lokale, nuk kanë vërtetuar kryerjen e krimeve të luftës e kundër njerëzimit, në mënyrë sistematike a masive nga ana e UÇK-së si formacion a nga drejtues e segmente drejtuese të saj. Në mbyllje të veprimtarisë së Gjykatës së Hagës, UÇK-ja, si formacion, dhe zinxhiri drejtues i saj kanë dalë, ashtu siç janë vlerësuar e mbështetur nga institucionet e opinionit i shëndoshë ndërkombëtar gjatë gjithë periudhës së luftës në Kosovë, si një forcë çlirimtare që drejtoi luftën dhe rezistencën popullore për liri e pavarësi me përkrahjen e NATO-s dhe shteteve e institucioneve demokratike.[14] Këtij skenari, filmi në fakt, i mungon vetëm epilogu, i cili nuk shkruhet, por lihet të nënkuptohet që Kosova, ndoshta, do të ishte më mirë që të administrohej sërish nga Serbia, pasi ky shtet është shtet zotëri, të vret si vrau në Bosnjë dhe Kosovë por, të paktën, është i qytetëruar, nuk i tejkalon normat ndërkombëtare të luftës dhe nuk bën trafik organesh me kufomat e vrara. Kurse këta shqiptarët duket që s'e meritojnë lirinë, janë barbarë, pasi mu në mes të fitimit të saj e kanë mendjen të bëjnë para me trafiqe organesh. Edhefilozofi francez Monteni që përshkruan

Instituti Albanologjik  
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë  
Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës

USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS  
vlerë kombëtare

sesion shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022

ASHAK



veset e kanibalëve në esenë e njohur të tij për ta, do ta kishte zili stilin përshkrues të Del Pontes, solemnitetin e deklarimeve të Dick Martyt dhe njohurinë e gjerë rreth çështjeve ballkanike të Lavrovit. Skenave të përshkuara më lart, po të mos diheshin ngjarjet, mund t'u vije çfarëdolloj viti poshtë si vit kur zhvillohen ngjarjet pasi kjo histori ngjan si dy pika uji me shumë histori të stisura rreth shqiptarëve, të paktën këtu e 150 vjet qëkur çështja e formimit të shtetit shqiptar ka dalë në skenë. Ajo që me të vërtetë mbetet shqetësuese në gjithë këtë histori është pohimi që shumë mballoma të kësaj historie Marty për ta thurur pëlhurën e vjetër të paragjyqimeve antishqiptare i ka huazuar nga akuza të politikës shqiptare në Kosovë mes palëve. Papërgjegjshmëria e deklarimeve, thjesht dhe për kapital politik të çastit, është një sëmundje kronike e gjithë politikës shqiptare që sa vjen nga papjekuria e atyre që merren me politikë po aq ka brenda dhe trillin krijues ballkanik popullor shqiptar. Duke vazhduar të silltet në mënyrë folklorike klasa politike shqiptare për shumë kohë ende do të vazhdojë të jetë viktimë e papërgjegjshmërisë së vet, e paaftë të ndërtojë vektorë besueshmërie për atë çka kërkon dhe deklaron.

Në histori mitin nga ngjarjet e vërteta e ndan besueshmëria e këtyre të fundit e bazuar në dokumente të burimeve parësore. Ka ardhur koha që dhe klasa politike shqiptare në rajon të ndjekë rastin e shkrimi të historisë dhe që të bëhet e besueshme për ato çka deklaron duhet të sjellë para opinionit platformat, idetë dhe zhvillimet ekonomike të vendit dhe jo broçkullat dhe pallavrakët e thashethemnajave provinciale dhe ambicie politike brenda llojit të vet. Në fakt, në reagimin e përbashkët që ajo pati këndeje dhe andej kufirit ndaj raportit të Martyt, pjesa më thelbësore dhe sfida e saj ndaj të ardhmes nuk mbetet bashkimi i saj para kësaj dukurie, pasi kjo gjë është vërejtur dhe më parë, por gjetja e "burimeve parësore" të veta, pra ndërtimi i kodit të ri etik dhe një morali ri politik në marrëdhëniet e saj brenda vetes dhe për ta gëzuar pjekurinë dhe lirinë politike. Të gjitha këto nuk përputhen me të vërtetat historike, të tashme e të asaj kohe. UÇK-ja, si forca kryesore e luftës dhe rezistencës së popullit shqiptar të Kosovës, është vlerësuar e do të vlerësohet si një reagim legjitim i një populli për të mbijetuar ndaj spastrimit etnik shekullor dhe masakrave e shpërnguljes biblike, të kryer tashmë në shekullin 20; një forcë që me përkrahjen e NATO-s dhe forcave demokratike çoi në

çlirimin e pavarësimin e Kosovës dhe vendosjen e një rendi demokratik, të bazuar mbi bashkëjetesën ndër-etnike. Vlerësimi do të jetë i tillë, pasi përcaktimin e karakterin e ngjarjeve të mëdha historike nuk e bëjnë gjykatat, por vetë historia dhe e vërteta, të mbartura e të bazuara në dëshmitë dhe kujtesën publike e institucionale. [15]

Për ta merituar këtë liri politike Kosovës i duhet të afrohet sa më pranë vlerave të aleatëve të saj strategjikë, ndaj përforcimi i demokracisë dhe rritja ekonomike do të ishin dy shtylla të mira prej nga do të ngrinte shumë më lehtë ngrehinën e triumfit të demokracisë liberale në Kosovë. Ndryshimi i vizionit dhe fillimi i një politike moderne ndaj të drejtave të shqiptarëve në rajon, duke lënë pas retorikat boshe nacionaliste dhe duke ridimensionuar të gjitha potencialet e bashkëpunimit ndër shqiptarë, ka hapur rrugën për një afrim gjithnjë e më të madh mes dy shteteve shqiptare. Ndjekja e modelit evropian, ku pikësëpari synohet një ekonomi e fortë e përbashkët, ku njëra ta plotësojë tjetrën dhe anasjelltas, hedh themelet për një premisë shpresëdhënëse për krijimin e një zone albanosfere në ekonomi që do të bëjë të mundur që faktori shqiptar të mos jetë i përçarë nën ombrellën e sferave të tjera ekonomike, por edhe të ketë mundësinë që t'i shpalosë dimensionet e tij në të gjitha fushat e tjera, si arsim, kulturë, energjetikë, bujqësi etj.

Ky proces është krenarësisht i natyrshëm dhe nuk ka pse paragjykohet për sa kohë është një projekt evropian dhe vjen si premisë e një bashkëpunimi rajonal. Ndjeshmëritë e Shqipërisë si shtet përkundrejt bashkëkombësve të vet për ta realizuar lëvizjen e lirë të shtetasve të Republikës së Kosovës në Evropë, mbrojtjen e identitetit kombëtar e kulturor shqiptar në Mal të Zi apo zbatimin e marrëveshjes së Ohrit në Maqedoni, duhen parë si lëvizje emancipuese brenda një kuadri evropian ashtu si kanë qenë të kuptueshme dhe vazhdojnë të jenë interesimet e Greqisë për Qipron, apo të Hungarisë për të drejtat e hungarezëve në Rumani e gjithandej ku harta politike e shteteve evropiane nuk korrespondon me atë të kombeve. Patriotizmi shqiptar i elitës andej dhe këndeje kufijve nuk ka pse matet vetëm me mirëqeverisje, luftë kundër korrupsionit dhe administrim territori, por edhe me bashkëpunim të mirëfilltë ekonomik që eliminon praktikrat korruptive për tregtinë midis dy vendeve, kulturë të përbashkët pa kufij

që rrëzon muret e vjetra të ndërtuar mes vete, administrim të përbashkët të baseneve ujore të Drinit dhe bashkëpunim të përbashkët në energji për t'i shmangur krizat ekonomike që i qëndrojnë si shpatë e Domekleut mbi kokë demokracisë. Shqiptarët janë të ndërgjegjshëm që për ta shekulli XXI, shekulli ku liria dhe të drejtat e njeriut janë kthyer tashmë në një vlerë universale dhe standarde të vlerësimit të demokracisë, është shekulli i shumëpritur për ta shijuar lirinë e mohuar të shekullit XX të mbisunduar nga nacionalizmi etnik, ideologjitë ekstreme dhe Lufta e Ftohtë. Për këtë arsye ata duhet të kontribuojnë po aq sa të tjerët për ndërtimin e një paqeje afatgjatë në Ballkan, duke e parë të shkuarën si një refleksim historik për të nxjerrë mësim dhe jo si një instrument të pavlerë që i nënshtrohet vetëm stendës së muzeve. [16]

Përpjekjet për të arritur një stabilitet të Kosovës dhe mirëqenitë qytetarëve të saj nuk duhet të monopolizohen nga askush, por të jenë përpjekje gjithëpërfshirëse që do të bëjnë të mundur arrijten e qëllimit final të disa brezave e gjeneratave andej dhe këndeje kufirit.

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

[1] Shih për më tepër Francis Fukuyama, The End of History and the Last Man, Penguin Adult, 1992.

[2] E. T. (Hyskaj), Sfidat e nacionalizmit, rasti i Ballkanit, Progres, Tiranë, 2008, f. 26.

[3] Po aty f. 182.

[4] Ilir Kalemaj, Tranzicioni i vështirë i Shqipërisë: saga e një historie ende të papërfunduar. Nga komunizmi drejt demokracisë tranzicioni shqiptar Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 2017, f. 100.

[5] Disa vende kontestuese të pavarësisë së Kosovës e kanë parë aktin e shpalljes së saj si dhunim të ligjit ndërkombëtar. Këtu përshihen Federata Ruse, Republika Popullore e Kinës, disa vende arabe dhe pesë

vende të Bashkimit Evropian: Greqia, Rumania, Sllovakia, Qiproja dhe Spanja.

[6] 23-vjetori i UÇK-së / Deklaratë e përbashkët e institucioneve shkencore dhe kulturore të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut. Gjendet në <https://ata.gov.al/2020/11/27/23-vjetori-i-uck-se-deklarate-e-perbashket-e-institucione-shkencore-e-kulturore-te-kosoves-shqiperise-dhe-maqedonise-se-veriut/>.

[7] Jacques Baudouin, Lindja e një demokracie: Hashim Thaçi dhe rruga drejt Kosovës së pavarur (1987-2008), Buzuku, Prishtinë, 2018.

[8] Vendimi për Kosovën nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ishte përgjigje ndaj një kërkesë për një opinion këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara lidhur me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ky ishte rasti i parë në lidhje me një shpallje të pavarësisë që u paraqit para kësaj gjykate. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me qendër në Hagë, që përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, publikoi pasditen e datës 22 korrik 2010 opinionin këshilldhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Gjatë fjalës së tij, kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, z. Hisashi Owada, tha: Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Me 10 vota për dhe 4 kundër, gjykata është e mendimit se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Sipas gjykatës, nga të gjitha të dhënat del se Pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur as Rezolutën 1244, as Kornizën Kushtetuese të UNMIK-ut. Në favor të Kosovës kanë votuar këta gjyqtarë: Hisashi Owada – nga Japonia, president i GjND-së, Thomas Buergenthal nga ShBA, Christopher Greenwood nga Britania e Madhe, Ronny Abraham nga Franca, Bruno Simma nga Gjermania, Kenneth Keith nga Zelanda e Re, Awn Shawkat Al-Khasawneh nga Jordania, Antônio A. Cançado Trindade nga Brazili, Abdulqawi Ahmed Yusuf nga Somalia, Bernardo Sepúlveda – Amor nga Meksika. Kundër Kosovës kanë votuar këta gjyqtarë: Peter Tomka – nënpresident, përfaqësues nga Sllovakia, Leonid Skotnikov nga Federata Ruse, Abdul G. Koroma nga Sierra Leone, Mohamed Bennouna nga Maroku. Shih për më tepër Adam Tanner, Reed Stevenson (22 korrik 2010). "Kosovo

independence declaration deemed legal" (në anglisht), "Reuters". Marrë më 15.06.2022 dhe Howard Clark, Civil Resistance in Kosovo, p. 73. Pluto Press, 2000.

[9] Kultura shqiptare njihet si baza e saj përcaktimet që ka dhënë Jacques Delor: filozofinë antike si bazë e racionalizmit të sotëm evropian, të drejtën romake si ndërtim i shtetit modern të së drejtës dhe vlerat e kristianizmit si vlera humane dhe universale të njeriut. Në rastin e kulturës shqiptare ajo është e pasuruar dhe me vlerat e islamizmit si pasqyrim i diversitetit të Evropës, një tipar të cilin shumë studiuues, përfshirë edhe hartuesin e Kushtetutës evropiane, ish-presidentin francez Valéry Marie René Giscard d'Estaing, e konsiderojnë si një nga "vlerat universale të Evropës".

[10] 23-vjetori i UÇK-së / Deklaratë e përbashkët e institucioneve shkencore dhe kulturore të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut. Gjendet në <https://ata.gov.al/2020/11/27/23-vjetori-i-uck-se-deklarate-e-perbashket-e-institucione-shkencore-e-kulturore-te-kosoves-shqiperise-dhe-maqedonise-se-veriut/>

[11] Dorian Koçi, Misioni fisnik i Lëvizjes Vetëvendosje, Gazeta Shqip, 13 dhjetor 2010.

[12] 23-vjetori i UÇK-së / Deklaratë e përbashkët e institucioneve shkencore dhe kulturore të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut. Gjendet në <https://ata.gov.al/2020/11/27/23-vjetori-i-uck-se-deklarate-e-perbashket-e-institucione-shkencore-e-kulturore-te-kosoves-shqiperise-dhe-maqedonise-se-veriut/>.

[13] Dorian Koçi, Raporti i Dick Martyt dhe politika shqiptare, Gazeta Shqip, 24 dhjetor 2010.

[14] 23-vjetori i UÇK-së / Deklaratë e përbashkët e institucioneve shkencore e kulturore të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut. Gjendet në <https://ata.gov.al/2020/11/27/23-vjetori-i-uck-se-deklarate-e-perbashket-e-institucione-shkencore-e-kulturore-te-kosoves-shqiperise-dhe-maqedonise-se-veriut/>

[15] 23-vjetori i UÇK-së / Deklaratë e përbashkët e institucioneve shkencore dhe kulturore të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut. Gjendet në <https://ata.gov.al/2020/11/27/23-vjetori-i-uck-se-deklarate-e-perbashket-e-institucione-shkencore-e-kulturore-te-kosoves-shqiperise-dhe-maqedonise-se-veriut/>

[16] Dorian Koçi, Marrëdhëniet serbo-shqiptare dhe shqetësimi evropian, Gazeta Shqip, 13 prill 2015.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Portugalia dhe Brazili sigurojnë kualifikimin

LUSAIL, 28 NËNTOR - Portugalia ka shënuar fitore 2-0 ndaj Uruguait dhe siguron një biletë për në fazën tjetër të Kupës së Botës. "Luzitanët" në fakt e nisën më mirë me dy tentativa të Joao Felix dhe Ronaldos, që do të devijoheshin nga mbrojtja kundërshtarë. Ndërkohë në krahun tjetër, Bentancur kishte shansin më të mirë përballë portierit në minutën e 32-të, por Costa e ndali mjaft mirë. Portugalia luan më mirë në pjesën e dytë dhe do të gjente dhe golin. Në minutën e 54-t, Bruno Fernandes jep një krosim magjik për Cristiano Ronaldo, i cili e prek me flokë, por FIFA ia ka atribuar mesfushorit dhe jo atij. Uruguai tentoi të reagoonte, por shtylla për fatin e keq do të ndalte një goditje të Gomez. Luzitanët ishin me fat, pasi në fundin e ndeshjes do të fitonin një penallti, që do të kthehej në gol nga Bruno Fernandes. Portugalia siguron kualifikimin me këtë fitore, pasi udhëheq me 6 pikë. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi ka qenë një ndeshje spektakolare ajo mes Koresë së Jugut dhe Ganës e cila u mbyll 2-3 me fitoren e ekipit afrikan. Pjesa e parë u mbyll me



avantazhin e dyfishët të Ganës teksa realizuan me Salisu 24' dhe Kudus 34'. Por në pjesën e dytë Korea u kundërpërgjigj duke barazuar shifrat nga dopieta e Cho Gue-Sung 58' 61'. Megjithatë ekipi afrikan nuk u dorëzua dhe gjeti golin fitores me Kudus në 68' i cili e mbyll këtë sfidë me dopietë. Kjo fitore e ngjit Ganën në vendin e 2 me 3 pikë, po aq sa ka dhe Portugalia që luan në mbrëmje ndaj Uruguait. Ndërkohë Grupin H e mbyll Uruguai në vendin e 3 me 1 pikë po aq sa ka dhe Koreja e

Jugut. Brazili merr një fitore të madhe 1-0 ndaj Zvicrës dhe siguron kualifikimin për në fazën tjetër. Edhe pse pa Neymarin, skuadra e Tite dominon në lojë dhe raste. Pjesa e parë nuk kishte shumë emocione. Mundësinë më të mirë e kishte "Selecao" në minutën e 27-të. Rafinha jep një krosim të bukur në zonë, atje ku Vinicius nuk arrin ta godas shumë mirë topin, duke bërë që Sommer ta kuptojë dhe ta presë. Në vendin e Neymar, të dëmtuar, u aktivizua Paqueta,

duke bërë një paraqitje të mirë. Në fundin e pjesës së parë për shumë pak sekonda ikën dhe dritat, një episod që shkaktoi dhe pak humor. Brazili vijoi lojën e mirë dhe në pjesën e dytë, ku do të gjente golin me Vinicius Junior, i cili shënoi përballë portierit, por arbitri e anuloi me VAR për shkak të një pozicioni jashtë loje të Richarlison. Gjithsesi goli do të vinte 7 minuta nga fundi, por këtë herë i rregullt. Në minutën e 83-të, pas një aksioni të bukur Rodrygo jep një pasim për

**Grupi G**

Kamerun-Serbia 3-3  
Brazili-Zvicra 1-0

**Tabela**

	Pikë
1. Brazili	6
2. Zvicra	3
3. Kameruni	1
4. Serbia	1

**Grupi H**

Portugalia-Uruguai 2-0  
Koreja Jugut-Gana 2-3

**Tabela**

	Pikë
1. Portugalia	6
2. Gana	3
3. Koreja Jugut	1
4. Uruguai	1

Casemiron, i cili shënon një super gol me një goditje fluturimthi. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi Kameruni dhe Serbia regjistruan barazimin me më shumë gola të Botërorit të Katarit, teksa u ndanë në barazim 3-3 mes tyre. Një pikë që vlen pak për synimin e kualifikimit, por që i mban në lojë në ndeshjet e treta në grup.

## Fitorja e gjashtë radhazi për Yllin, Peja mposhti Trepçën

GJAKOVË, 28 NËNTOR - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore në udhëtim ndaj Vëllaznimit me rezultat 77:80 (16:17, 22:28, 24:16, 15:19), në xhiron e 12-të të Prince Caffè Superligës. Takimi ishte shumë interesant, me kthesa dhe një atmosferë fantastike që u vendos fituesi në sekondat e fundit. Mysafirët e nisën ndeshjen shumë më mirë, me një seri prej 0:8, ku vendasit nuk shënuan pothuajse pesë minuta, e më pas epërsia thellohet në 1:12, megjithatë, kuqezinjtë shpejt këndellën dhe afrojnë shifrat në 16:17, me një trepikësh në sirenën e



fundit nga Burim Zekiqi. Lojë e barabartë u zhvillua në pesë minutat e para të pjesës së dytë, por në fundin e kësaj

pjesë, therandasit ishin më të mirë, duke shkuar në pushim me rezultat 38:45. Ylli në periodën e tretë kishte epërsi

deri në 11 pikë, 44:55, por nga ky moment skuadra nga Gjakova fillon një seri të suksesshme dhe kalon në epërsi 59:57, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 62:61. Ndeshje shumë interesante dhe dramatike u zhvillua deri në fund, ku të dy skuadrat kishin mundësi të fitonin, por më të vëmendshëm ishin kampionët, ndërsa vendasit nuk e shfrytëzuan një aksion në fund dhe rezultati përfundimtar ishte 77:80. Te Vëllaznimi u dallua Damonte Dodd me 21 pikë e 17 kërcime, kurse te Golden Eagle Ylli u dallua

Bashir Ahmed me 27 pikë e pesë kërcime. Kuqezinjtë kanë pesë fitore e shtatë humbje, kurse therandasit gjashtë fitore e katër humbje. Peja ka fituar derbin e javës së 12-të, duke mundur Trepçën në udhëtim me shifrat 68:71 (18:22, 11:17, 14:15, 25:17). Te Trepça u dalluan Ken Brown me 21 pikë dhe Drilon Hajrizi me 16, ndërsa te Peja më i miri ishte Brad Waldow me 22 pikë e 16 kërcime, kurse Purvis e ndihmoi me 14 pikë. Mitrovicasit kanë gjashtë fitore e gjashtë humbje, kurse pejanët nëntë fitore e dy humbje.

## Ballkani e Prishtina me fitore bindëse, Llapi merr një pikë në Malishevë

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Ballkani dhe Prishtina kanë shënuar fitore si mysafire dhe atë me rezultate bindëse në kuadër të javës së 18-të (të fundit për stinorin vjeshtor) në AlbiMall Superligën e Kosovës në futboll. Kampioni në fuqi triumfoi në duel me Gjilanin, me shifrat 3:0, me dy gola të Ermal Krasniqit (67' e 90') dhe një gol të Bajram

Jashanicës (37'). Pas kësaj fitoreje Ballkani vazhdon të qëndrojë në pozitën e dytë, me 33 pikë, 5 më pak se Drita, por i ka edhe tri ndeshje të mbetur të këtij stinori për shkak të pjesëmarrjes në garat evropiane. E pikërisht një ndeshje të mbetur me Ballkanin e ka edhe Prishtina. Kjo e fundit, të dielën fitoi me të njëjtin rezultat në

stadiumin "Riza Lushta" në duel me Trepçën'89, duke i dhënë fund serisë prej katër ndeshjeve pa fitore. Rezultatit e zhbllkoi Kreshnik Uka, në minutën e 39-të, derisa më pas në pjesën e dytë fitorja u vulos nga golat e Muhamed Useinit dhe Ramiz Bytyqit. Ndërkohë, dueli ndërmjet Malishevës dhe Llapit nuk ka prodhuar fitues por as gola.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1905

Columbus, Georgia, USA  
0.5L